




Feja e vërtetë

Vepër e
nevojtarit për faljen e Allahut të Lartë,
Abdurrahman Ibn Hammad Alu Omer
1473 - 1354 Hijri

من إصدارات



مؤسسة عبد الرحمن بن هammad
عبد الرحمن بن هammad
ABDULRAHMAN H. AL OMAR CHARITABLE FOUNDATION

جمعية خدمة المحتوى
الإسلامي باللغات



دين الحق - ألباني

Abdurrahman ibn Hammad Alu Omer

Feja e vërtetë

Përktheu: Mirsim Maliçi

Redaktor fetar: Arben Ahmetaj

Redaktor gjuhësor: Arsim Jonuzi

جمعية خدمة المحتوى الإسلامي باللغات ، ١٤٤٣ هـ

ح

فهرسة مكتبة الملك فهد الوطنية أثناء النشر

العمر ، عبدالرحمن بن حماد

دين الحق - باللغة الالبانية. / عبدالرحمن بن حماد العمر - ط.١. -

، الرياض ، ١٤٤٣ هـ

١٢٦ ص ؛ ١٤ × ٢١ سم

ردمك: ٨-١١٢٣-٠٤-٦٠٣-٩٧٨

١- الاسلام أ. العنوان

١٤٤٣ / ١١٦٣٩

ديوي ٢١٠

شركاء التنفيذ:



المحتوى الإسلامي



رواد الترجمة



جمعية الربوة



دار الإسلام

يتاح طباعة هذا الإصدار ونشره بأي وسيلة مع

الالتزام بالإشارة إلى المصدر وعدم التغيير في النص.



Tel: +966 50 244 7000



info@islamiccontent.org



Riyadh 13245- 2836



www.islamhouse.com

دين الحق

(باللغة الألبانية)



تأليف: عبد الرحمن بن حماد ال عمر

ترجمة: ميرسيم ماليشي

مراجعة شرعية: أرين أحماتي

مراجعة لغوية: أرسيم يونسي



Me emrin e Allahut, të Mëshirshmit, Mëshiruesit

Hyrje dhe kushtim

Falënderimet e përkryera janë për Zotin e botëve, kurse mëshira dhe paqja e Zotit qofshin për mbarë profetët e Tij. Thirrje për çdo mendar - grishje për shpëtim, me shpresë që kushdo që ka humbur rrugën, të përudhet, e ne, bashkë me ata që e përhapin këtë thirrje, të shpërblehemi:

Dije, o njeri i arsyeshëm, se nuk ka ndryshe shpëtim e lumturi në këtë jetë dhe në atë të mëtejmen, përveçse duke e njohur, adhuruar e besuar Zotin e Vërtetë – Krijuesin tënd; sikurse, edhe duke e njohur Profetin që Zoti ta dërgoi ty dhe mbarë njerëzve, e duke e shoqëruar këtë njohje me besim e pasim. E ky shpëtim nuk mendohet dot pa njohjen, përqaftimin dhe jetësimin e fesë së vërtetë.

Libri që ke në duar - "Feja e vërtetë", të jep shpjegime rreth këtyre çështjeve madhështore, të cilat duhet t'i njohësh e

t'i jetësosh. Në fusnota të kam dhënë disa sqarime shtesë, përherë duke u mbështetur në fjalën e Zotit të Lartë dhe në fjalët e Profetit ﷺ,¹ ngase feja e së vërtetës buron nga këto fjalë dhe vetëm në to mbështetet.

E kam tërhequr mënjanë pasimin e verbër – këtë devijues shkatërrimtar. Sikurse edhe kam folur rreth disa sekteve të devijuara, që e pandehin të vërtetën, kurse në të vërtetë janë larg saj, me synim që gjithsecili ta dijë realitetin e tyre. Më mjafton Allahu - vetëm Atij i jam dorëzuar!

E shkroi:

Nevojtar i për faljen e Allahut të Lartë,
Abdurrahman ibn Hammad Alu Omer
Mësimdhënës i shkencave fetare

¹ Sal-lallahu alejhi ue sel-lem (shqip: paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

Kreu i parë

Njohja e Allahut¹ – Krijuesit madhështor

O mendar! Dije se Zoti që të solli nga hiçi në ekzistencë e të mbarështoi me begati është Allahu, Zoti i botëve. Njerëzit e zgjuar, që besojnë në Zotin Madhështor, vërtet, nuk e kanë parë Atë me sytë e tyre, mirëpo i kanë parë sheshazi argumentet që flasin për ekzistencën e Tij, pra, dëshmitë që tregojnë se Ai është Krijuesi dhe Mbarështuesi i mbarë krijesave, e kështu pra, edhe e njohën. Disa nga këto argumente janë:

Argumenti i parë:

Gjithësia, njeriu dhe jeta janë prurje të sajuaara, ndaj edhe kanë një fillim e një mbarim, si dhe janë të ndërvarshme.

E diçka e shpikur që është nën varësinë e dikujt tjetër, doemos ajo është thjesht një krijesë, e cila nuk mendohet dot pa një Krijues dhe Ai Krijues Madhështor është Allahu. Për Qenien e Tij të Shenjtë na njoftoi vetë Ai – se Ai është Krijuesi dhe Mbarështuesi i të gjitha krijesave. Ky njoftim nga Zoti na erdhi në librat e Tij, të cilët Ai ia shpalli profetëve dhe kumtarëve të Vet.

Të dërguarit e Zotit ia kumtuan njerëzve fjalët e Tij e i thirrën që të besonin në Të dhe ta adhuronin vetëm Atë.

¹ "Allah" është emri i veçantë i Zotit të gjithësisë, të njerëzve dhe të çdo gjëje. Me këtë emër të përveçëm - domethënia e të cilit është: i adhuruari i vërtetë - Ai e ka quajtur Vetën e Tij të Shenjtë.

Zoti i Lartësuar në librin e Tij – në Kuranin Madhështor, thotë:

“Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, që krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Fronin hyjnor (mbi Arsh). Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhrin të Tij. Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë bekuar Allahu, Zoti i botëve!” (Kurani, 7:54)

Domethënia e përgjithshme e ajetit fisnik: Allahu i Madhërishëm u tregon mbarë njerëzve se Ai është Zoti i tyre, i Cili i ka sjellë ata në ekzistencë; Ai është që i ka krijuar qiejt e Tokën për gjashtë ditë.¹ Po ashtu, u tregon se Ai është i ngritur mbi Arsh² – krijesën më madhështore, e cila

¹ I solli qeniet gradualisht në ekzistencë, për një urtësi të dëshiruar nga Ai, madhëruar qoftë; edhe pse, në të vërtetë, Ai ka mundësi t'i krijojë mbarë krijesat në një interval edhe më të shkurtër kohor, madje më shpejt sesa një çelje-mbyllje sysh, ngase Ai na ka treguar se kur dëshiron diçka, veç thotë: "Bëhu!" dhe ajo bëhet!

² Në gjuhën e arabëve, e cila është gjuha e Kuranit, folja "isteva" - mbi diçka, ka domethënien e ngritjes dhe lartësimit sipër atij gjësendi. Kështu që, ngritja e Zotit mbi Arsh nënkupton lartësimin e Tij mbi të; gjithsesi, ky lartësim përkon me madhërinë e Tij, mirëpo nuk e di askush përpos Tij mënyrën e lartësimit. E domethënia e foljes "isteva" assesi nuk përfundon te kuptimi i kapjes dhe zotërimit të mbretërisë, siç pandehin të devijuarit, të cilët nuk e pranojnë realitetin e cilësive të Allahut, me të cilat Ai, po edhe profetët e nderuar, e kanë përshkruar Atë, madhëruar qoftë! Këta njerëz pretendojnë se sikur ata t'i pranonin e vërtetë cilësitë e Allahut ashtu siç janë në të vërtetë, kështu do t'i binte se ata e kanë

është mbi shtatë qiej, e mbi Arsh qëndron Zoti Fuqiplotë, i Cili, me diturinë, dëgjimin dhe shikimin e Tij është afër të gjitha krijesave të Veta. Asgjë nuk i fshihet Atij! Gjithashtu, në këtë ajet, na tregon se Ai e bëri që, nata me errësirën e saj ta mbulojë ditën dhe ta ndjekë atë me nguti. Po ashtu, na tregon se Ai i krijoi Diellin, Hënën dhe yjet, të cilat shtegtojnë secila në orbitat e veta, duke iu bindur komandës së Zotit Fuqiplotë. Gjithashtu tregon se krijimtaria dhe komandimi i përkasin vetëm Atij; Ai është Madhështori, i Përsosuri në qenien dhe cilësitë e Tij, Dhuruesi i mirësive të shumta e të përhershme dhe Zoti i botëve, që i solli krijesat në ekzistencë dhe i mbarështon ato me begatitë e Tij.

Allahu i Madhërishëm thotë:

“Ndër shenjat e Tij janë nata dhe dita, si dhe Dielli dhe Hëna. Mos bëni sexhde as për Diellin, as për Hënën, por, nëse jeni adhures të Atij, bëni sexhde për Allahun i Cili i ka krijuar ato!” (Kurani, 41:37)

shëmbëlltyr Zotin me krijesat e Tij. Pa dyshim, pretendimi i tyre nuk qëndron dhe është i kotë! Kjo ngase përngjasimi është, fjala bie, të thuash: "Ai ka këtë ngjashmëri me aksh krijesën!", ndërsa pranimi dhe vërtetimi i cilësive të Tij, duke besuar se ato cilësi janë ashtu siç i takon Zotit të Madhëruar, pa ndonjë ngjasim, shëmbëllim, shpjegim të formës, mohim e keqinterpretim, në të vërtetë, pikërisht kjo është rruga e profetëve, të cilën e kanë ndjekur të parët tanë të mirë. Kjo është ajo e vërtetë për të cilën duhet të kapet çdo besimtar, edhe nëse shumica e njerëzve kanë marrë rrugë të tjera.

Domethënia e përgjithshme e ajetit fisnik: Allahu tregon se prej shenjave që flasin për Të janë edhe nata, dita, Dielli e Hëna. Me ndalesë të prerë iu drejtua njerëzve, që të mos i bëjnë sexhde Diellit e Hënës, ngase ato janë krijesa sikur qeniet e tjera të krijuara, ndërsa krijesa, pa kurrfarë dyshimi, nuk është e denjë për adhurim, kurse sexhdja është një prej formave të adhurimit; në këtë ajet, po edhe gjetiu, Zoti jep urdhër që vetëm Atij t'i bëhet sexhde, ngase Ai është Krijuesi dhe Mbarështuesi – i Denji për t'u adhuruar!

Argumenti i dytë:

Krijimi i mashkullit dhe i femrës; pra, vetë ekzistenca e tyre flet për Zotin.

Argumenti i tretë:

Shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e racave; s'i gjen dot dy veta që e kanë të njëjtin zë a ngjyrë, e ata doemos dallojnë nga njëri-tjetri.

Argumenti i katërt:

Shumëllojësia e fateve; njëri i pasur e tjetri i varfër, njëri udhëheqës e tjetri vartës, edhe pse të gjithë mund të kenë mendje, ide e dituri. Edhe pse të gjithë kanë interesim e përpjekje për të pasur kamje, fisnikëri e grua të bukur, megjithatë asnjëri s'merr gjë tjetër përpos asaj që ia ka parapërcaktuar Zoti Fuqiplotë. Kjo si rrjedhojë e urtësisë madhështore, nëpërmjet së cilës Zoti dëshiron t'i vërë njerëzit në sprovë me njëri-tjetrin, po edhe t'i vërë në

shërbim të njëri-tjetrit, në mënyrë që të mos i humbasin interesat e tyre të ndërsjella.

E ai që s'është fatmadh në këtë jetë është njoftuar nga Zoti se fati e mbarësia e tij, nëse ai vdes duke e besuar Zotin, do t'i ruhen për jetën e mëtejme, që me to atje - në parajsë, t'i shtohet begatia dhe mirëqenia; edhe pse realisht, ai mund të jetë i begatuar me disa mirësi shpirtërore e shëndetësore, të cilat rrallë shihen tek të pasurit, kjo si rrjedhim i urtësisë dhe drejtësisë së Allahut të Madhërishëm.

Argumenti i pestë:

Gjumi dhe ëndrrat e vërteta, nëpërmjet të cilave Zoti ia shpalos të fjeturit disa gjëra nga bota e të fshehtës, qoftë si shenjë përgëzimi, apo edhe qortimi.

Argumenti i gjashtë:

Shpirti, realitetin e të cilit nuk e njeh askush përpos Allahut.

Argumenti i shtatë:

Njeriu, me gjithfarë që ka në qenien e tij, si shqisat, sistemi nervor, truri, sistemi i tretjes etj.

Argumenti i tetë:

Ringjallja e tokës së vdekur, nëpërmjet shiut të cilin e lëshon Zoti, e më pastaj nga ajo mbijnë bimë e pemë të ndryshme, që dallojnë nga njëra-tjetra në formën, ngjyrën, dobitë dhe shijet e tyre. Këto janë disa nga ato qindra argumente, të cilat Zoti i përmendi në Kuran si dëshmi që flasin se Ai

ekziston dhe se vetëm Ai është Krijuesi dhe Mbarësuesi i të gjitha krijesave.

Argumenti i nëntë:

Natyra fillestare, në të cilën Allahu i formoi e i krijoi njerëzit; pra, ajo natyrë e pastër dhe e paprekur, e beson ekzistencën e Zotit – Krijuesit dhe Drejtuesit të vet. Nëse mohon dhe e dëmton këtë natyrë, atëherë shpirti shuket dhe mjerohet. Ja, fjala bie, komunisti; ai është i vrarë në shpirt, ndërsa fundi i tij pas vdekjes është ferri – rezultat i merituar për përgënjeshtimin që i ka bërë Zotit, i cili e ka sjellë në ekzistencë nga hiçi dhe e mbarështoi me begati. Ky do të jetë vendbanimi i tij, nëse nuk kthehet me pendim te Zoti e të besojë në Të dhe në fenë dhe profetët e Tij.

Argumenti i dhjetë:

Bereqeti – begatia; të qenët me bollëk, shumicë e shtim, siç është rasti te disa krijesa si delet etj. Ndërsa e kundërta e bereqetit është dështimi e pakësimi, siç është rasti te qentë dhe macet.

Prej cilësive të Zotit është të qenët i Pari pa fillim, i Gjalli i Përhershëm – që nuk vdes e nuk i vjen fundi, i Pasuri (i Panevojë) - që ekziston i pavarur, e nuk ka nevojë për askënd e për asgjë, Njëshi – që nuk ka ortak. Allahu i Madhërishëm, thotë:

“Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilin i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as

nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Të!” (Kurani, 112:1-4)

Domethënia e këtyre ajeteve:

Kur jobesimtarët e pyetën vulën e profetëve – Profetin Muhamed صلی اللہ علیہ وسلم rreth vetisë së Zotit, atëherë Ai, madhëruar qoftë, ia shpalli Profetit të Tij këtë kaptinë dhe e urdhëroi t’u thotë atyre se Allahu është Një – i Vetëm, i pashoq; Ai është i Gjalli, i Përherëshmi, Mbarështuesi. Gjithësia, njerëzit dhe gjithçka që ekziston është nën komandën e Tij absolute; Vetëm tek Ai duhet të kthehen mbarë krijesat për nevojat e tyre!

Ai as nuk lind, e as nuk është i lindur. Atij s’i përket të ketë bir, bijë, baba e nënë. Në këtë kaptinë, po edhe gjetkë, i ka mohuar, e s’i ka pranuar assesi për Vetveten e Tij këto veti e këta emra, ngase ky varg breznie dhe lindja janë veti të krijesave e jo të Zotit Fuqiptotë. Andaj Ai i ka gjuhëzuar e mposhtur fjalët e kota të të krishterëve, të cilët thonë se: “Mesihu është i biri i Zotit!”; po edhe të hebrenjve, të cilët thonë se: “Uzejri është i biri i Zotit!”; si dhe të të tjerëve, që thonë se: “Engjëjt janë bijat e Zotit!”.

Po ashtu, Zoti na ka treguar se Ai, me fuqinë e Tij, e ka krijuar Mesihun Isa, -paqja qoftë mbi të!-, pa baba, sikurse e ka krijuar Ademin – babanë e njerëzimit, prej dheut, e Havanë – nënën e njerëzimit, prej bririt të Ademit, e ky e pa atë anësh pranë vetvetes, e më pastaj i krijoi njerëzit e tjerë nga lëngu i burrit dhe gruas. Në fillim fare, gjithçka që Ai e krijoi, e solli në ekzistencë nga hiçi, e më pastaj u formoi

atyre zakone e sisteme që nuk ndryshohen dot, përveçse nëse Ai Vetë, sipas dëshirës së Tij, bën ndonjë ndryshim, siç është rasti i krijimit të Isait, -alejhi's-selam!-, nga nëna e tij Merjemja, mirëpo pa baba; si dhe e folmja që iu mundësua atij fare herët, duke qenë në djep. Po edhe shembuj të tjerë, fjala vjen, ngjarja e Musait, ku shkopin e tij, Zoti e bëri gjarpër të lëvizshëm, e me të njëjtin shkop, Musai i mëshoi detit, pas të cilit deti u ça përgjysmë dhe u hap udha që Musai me popullin e vet të kalojë. E Profetit Muhamed ﷺ i ndodhën mrekulli të ndryshme, siç është ngjarja e çarjes së hënës, po edhe ato kur pemët e përshëndetnin, ndërsa kafshët dëshmonin për misionin e tij, duke lëshuar zë të dëgjueshëm për njerëzit përreth: “Unë dëshmoj se ti je i dërguari i Zotit!”. Pastaj ngjarja e “Israsë dhe Miraxhit”, në të cilën ai, nga xhamia e shenjtë bëri një udhëtim mbi kafshën “El-Burak”, për të mbërritur në xhaminë e El-Aksasë, e prej aty tutje, në shoqërinë e melekut Xhebrail, u ngrit në qiell dhe e përshkoi atë, derisa mbërriti mbi qiell, ku i foli Allahu i Madhërishëm dhe ia obligoi namazin, e më pastaj, u kthye në Tokë, në Xhaminë e Shenjtë, e përgjatë rrugës ai kishte parë banorët e çdo qielli; kjo ngjarje i ngjau atij përbrenda një nate të vetme, pa gdhirë fare agimi. Kjo ndodhi, pra ngjarja e “Israsë dhe miraxhit” është e njohur në Kuran dhe Sunet, po edhe historia ka shkruar për të.

E prej cilësive të Zotit të Lartë është dëgjimi, shikimi, dituria, fuqia e dëshira – pra, Ai dëgjon e sheh gjithçka dhe asgjë s’i fshihet dot.

E di mirëfilli se çfarë ka në mitra, e çfarë fshehin zemrat, ç'ishte, e çfarë do të jetë në të ardhmen. Ai është i Plotfuqishmi, i Cili, kur i thotë një gjësendi: "Bëhu!", menjëherë bëhet!

Prej cilësive me të cilat Zoti e ka përshkruar Vetën e Tij të Shenjtë është:

E folmja – Ai flet çfarë të dojë e kur të dojë. I ka folur Musait, -alejhi's-selam!-, po edhe vulës së vargut të profetëve – Muhamedit صلى الله عليه وسلم. Kurani, me shkronjat dhe kuptimet që ka është fjalë e Allahut. Ai ia zbriti atë profetit të Tij, Muhamedit صلى الله عليه وسلم. Pra, Kurani është prej cilësive të Tij e nuk është diçka e krijuar, siç thonë mutezilët e lajthitur.

Gjithashtu, prej cilësive me të cilat Zoti e ka përshkruar Vetveten dhe me të cilat e kanë përshkruar edhe profetët e Tij janë: fytyra, dy duart, ngritja (mbi Arsh), zbritja (në qiellin e dunjasë), pajtimi e hidhërimi.

Pra, Ai pajtohet dhe është i kënaqur me robërit e Tij besimtarë e zemërohet me jobesimtarët, po edhe me ata që e meritojnë zemëratën e Tij. Pajtimi dhe hidhërimi i Tij janë veti si mbarë vetitë e Tij të tjera: nuk kanë ngjashmëri me cilësitë e krijesave, nuk interpretohen duke ia shtrembëruar kuptimet e tyre, e as nuk shpjegohen si mund të jenë (modaliteti).

Në Kuran dhe Sunet, na është vërtetuar dhe qartësuar se besimtarët, në sheshet e botës së mëtejme dhe në parajsë, me sytë e tyre do ta shohin Allahun e Madhërishëm. Cilësitë

e Zotit të Plotfuqishëm janë shpjeguar gjerësisht në Kuranin Fisnik dhe në hadithet e Profetit të fisëm, Muhamedit ﷺ, ndaj shihni për më gjerësisht!

Qëllimi për të cilin Allahu i solli njerëzit dhe xhinët në ekzistencë

Nëse e ke kuptuar, o njeri i mençur, se Allahu është Zoti yt që të ka krijuar, atëherë dije se Ai nuk të solli në ekzistencë së koti, mirëpo të krijoi që ta adhurosh Atë. E argument që flet për këtë të vërtetë është vetë fjala e Zotit:

“Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre risk, as nuk dëshiroj që të Më ushqejnë. Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi.” (Kurani, 51:56-58)

Kuptimi i përgjithshëm i ajeteve:

Zoti i Lartë na tregon në ajetin e parë se Ai i krijoi xhinët¹ dhe llojin njerëzor vetëm e vetëm që ta adhurojnë Atë.

Kurse në ajetin e dytë dhe të tretë, na tregon se Ai nuk ka nevojë për robërit e Tij dhe nuk kërkon nga ta furnizim e ushqim, ngase Ai është Furnizuesi i vetëm e i Plotfuqishëm,

¹ Xhinët janë krijesa me aftësi mendimi. Ato i solli Allahu në ekzistencë për të njëjtin qëllim për çka e krijoi llojin njerëzor. Ata jetojnë bashkë me njerëzit në Tokë, mirëpo qenia njerëzore nuk arrin dot t'i shohë me sy

dhe se vetëm Ai u dërgon njerëzve dhe mbarë krijesave furnizim – shi prej qielli, e begati nga toka.

Kurse krijesat e tjera në Tokë, të cilat nuk e kanë aftësinë e mendimit dhe të ndërgjegjes, për to Zoti na tregon se i ka sjellë në ekzistencë për interesin e njeriut, që ai, me fuqinë e fituar, ta adhurojë Zotin, po edhe t'i trajtojë ato sipas ligjit të Tij. Secilën krijesë, lëvizje e qetësi në kozmos, Allahu e ka krijuar për një aksh urtësi, të cilën e ka sqaruar në Kuranin Famëlartë, e të cilën mund ta njohin edhe dijetarët e fesë, varësisht nga dija e tyre. Madje, edhe ymret, furnizimet, ngjarjet dhe fatkeqësitë e shumëllojta, të gjitha ndodhin në sajë të lejes së Tij, që kështu Ai t'i vërë në sprovë robërit e Tij të mençur. Pra, kush pajtohet me parapërcaktimin e Zotit, i dorëzohet Atij dhe përpiqet që me vepra të mira ta fitojë pajtimin e kënaqësinë e Tij, ai do të arrijë atë, po edhe lumturinë në këtë botë, si dhe në botën e mëtejme pas vdekjes. E kushdo që nuk pajtohet me parapërcaktimin e Zotit, nuk i dorëzohet, e s'i bindet Atij, ai do të merr hidhërimin e Tij, e do të mjerohet në të dy jetët, në atë të kësaj bote dhe në atë të mëtejmen. I përgjërohëm Zotit që të na japë pajtimin e Tij dhe të mos zemërohet me ne.

Ringjallja pas vdekjes, llogaria dhe shpërblimet për veprat e bëra, parajsa dhe skëterra (Xheneti dhe Xhehenemi)

O njeri i arsyeshëm! Nëse e ke kuptuar se Zoti të ka sjellë në ekzistencë, në mënyrë që ta adhurosh Atë, tani dije se Ai, në të gjithë librat e shpallur të ka sjellë lajmin e ringjalljes pas vdekjes dhe të llogaridhënies në botën e shpërblimeve. Vdekja është dera e transferimit të njeriut nga kjo jetë e përkohshme, në të cilën duhet vepruar, për te bota tjetër e përhershme, në të cilën merren shpërblimet. Zoti ia ka përcaktuar secilit nga ne periudhën e jetëgjatësisë, pas përfundimit të së cilës, Ai urdhëron melekun e vdekjes që njeriut t'ia nxjerrë shpirtin; e me këtë ai vdes dhe e përjeton hidhësinë e vdekjes.

E sa i përket shpirtit; nëse është shpirt besimtar, që i është bindur Zotit, ai vendoset në vendin e begative - në parajsë; e nëse është shpirt jobesimtar, që e ka përgënjeshtuar ringjalljen dhe llogarinë pas vdekjes, atë Zoti e vendos në vendin e ndëshkimit - në ferr, derisa të vijë momenti i fundit i botës, e të ndodhë kiameti e të vdes çdo krijesë. Pastaj Zoti i ringjall krijesat, madje edhe kafshët dhe e kthen çdo shpirt tek trupi i vet, atëherë kur të rikthehet edhe vetë trupi, ashtu siç kanë qenë në të parën herë kur është krijuar.

E tërë kjo në mënyrë që të merren njerëzit në llogari e të shpërblehen për punët e tyre; gjithsecili, pa ndonjë përjashtim, qoftë mashkull a femër, pari a popull, pasanik a varfanjak. Askujt s'i bëhet padrejtësi; aty çdonjëri që është shtypur më parë në këtë botë, do ta marrë hakun e tyre nga

shtypësit, e madje edhe kafshët do të marrin hakun e vet kundrejt atyre që u kanë bërë padrejtësi.

Pasi të kenë përfunduar hakmarrjen kafshët ndërmjet vete, u vjen urdhri që të bëhen dhé, ngase ato nuk do të futen as në parajsë e as në ferr.

Njerëz e xhinë, që të gjithë do të marrin rezultatin e punëve të tyre. Besimtarët që kanë besuar Zotin e Madhërishëm, i janë bindur Atij dhe i kanë pasuar profetët, e fitojnë parajsën, edhe nëse në këtë jetë ishin nga më të varfrit. Ndryshe nga jobesimtarët përgënjeshtues, të cilët edhe sikur të kishin qenë në botën e përkohshme prej njerëzve më të pasur e më të nderuar, pashmangshëm do të futen në zjarrin e xhehenemit.

Allahu i Madhërishëm thotë:

“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.” (Kurani, 49:13)

Xheneti - parajsa është vendi i begative. Aty mirësitë dhe begatitë janë të shumëllojta e të papërshkrueshme. Parajsa është njëqindgradëshe, ku banorët e zënë vendin varësisht fuqisë së besimit në Zotin dhe bindjes ndaj Tij. Grada më e vogël në parajsë është po sikur shtatëdhjetë herë pasuria dhe begatia që ka pasur mbreti më i kamur në Tokë.

Kurse ferri, -Zot, ruana!- është vendi i dënimit në botën e fundit dhe të pasosur, gjegjësisht pas vdekjes. Aty llojet e dënimeve dhe të ndëshkimeve janë të shumta - vetëm

përmendja e tyre e trishton zemrën dhe e mbush syrin me lot.

Sikur të ekzistonte mundësia e vdekjes në botën tjetër, sakaq banorët e xhehenemit do të vdisnin me të parën herë kur do ta shihnin ferrin e tmerrshëm. Mirëpo vdekja është diçka që ndodh vetëm një herë - për t'u transferuar njeriu nga jeta e kësaj bote, për në jetën e amshueshme të ahiretit.

Në Kuran na është përmendur përshkrimi i plotë i vdekjes, i ringjalljes, i llogarisë, i shpërblimit, i xhenetit e i ferrit; e kjo çka përmendëm është diçka nga ajo.

Argumentet që flasin për ringjalljen pas vdekjes, llogarinë dhe shpërblimet janë të shumta. Në Kuranin madhështor, Zoti Fuqiplotë thotë:

“Ne ju kemi krijuar prej tokës, aty do t’ju kthejmë dhe nga ajo do t’ju nxjerrim edhe një herë tjetër.” (Kurani, 20:55)

Po ashtu, Allahu i Lartësuar thotë:

“Ai na sjell shembull, duke harruar krijimin e vet dhe thotë: “Kush do t’i ngjallë eshtrat kur të kalben?” Thuaj: “Do t’i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë.” (Kurani, 36:78-79)

Gjithashtu, i Larti thotë:

“Mohuesit kujtojnë se nuk do të ringjallen kurrësi. Thuaju: “Po, për Zotin tim, me siguri që do të ringjallen e

pastaj do të njoftoheni për atë ç'keni bërë!" Dhe kjo është e lehtë për Allahun." (Kurani, 64:7)

Kuptimi i përgjithshëm i ajeteve:

Zoti i Madhëruar na tregon në ajetin e parë se qenien njerëzore e ka krijuar nga Toka, gjegjësisht lënda e krijimit të Ademit ishte dheu, ku do ta kthejë Zoti, në mënyrë që ta nderojë njeriun pas vdekjes. E sërish nga dheu Zoti do të na nxjerrë e njerëzit do të dalin të gjallë prej varreve të tyre, që nga i pari e deri te i fundit. Pastaj, Zoti do t'i marrë njerëzit në llogari e do t'i shpërblejë për punët e bëra.

E në ajetin e dytë, Zoti e mposht pretendimin dhe habinë e jobesimtarit që e përgënjeshtrojnë rikthimin e eshtrave në jetë pasi ato të jenë kalbur; Ai u tregon se ato do t'i ringjallë, ngase vetë Ai i krijoi ato herën e parë kur nuk ishin asgjë.

Ndërsa në ajetin e tretë, Zoti e shpartallon pretendimin e kotë të jobesimtarëve që e përgënjeshtrojnë ringjalljen pas vdekjes; Po ashtu, Ai e urdhëron Profetin e tij, që të betohet fuqishëm që, Zoti do t'i ringjallë të gjithë, do t'i njoftojë për bëmat e tyre dhe do t'i shpërblejë. E kjo, vërtet është fare e lehtë për Allahun Fuqiplotë.

Në një ajet tjetër, Zoti na tregon se kur t'i ringjallë mohuesit dhe përgënjeshtguesit e ringjalljes dhe të ferrit, do t'i ndëshkojë ata me zjarr të xhehenemit.

E atyre u thuhet: **"Shijoni dënimin e zjarrit, të cilin e mohoni!" (Kurani, 32:20)**

Mbarështimi i punëve dhe fjalëve të njeriut:

Allahu i Lartëmadhërishëm na ka treguar se me dijeninë e Tij absolute, Ai e ka ditur se çfarë punë e fjalë, qofshin të mira a të këqija, haptazi e fshehurazi, do të dalin nga njeriu. Ai të gjitha këto i ka shkruar në “El-Lewḥu’l-maḥfūdh” që është tek Ai, përpara se të krijonte qiejt, Tokën, njeriun dhe krijesat e tjera. E megjithatë, ai i ka angazhuar dy engjëj për çdo njeri, që njëri nga ana e djathtë të shënojë veprat e mira, kurse tjetri nga ana e majtë të shënojë veprat e liga - e atyre s'u ikën asgjë!

Çdo njeriu, në Ditën e Llogarisë, do t'i jepet libri ku janë regjistruar veprat dhe fjalët e tij; ai do ta lexojë atë, e nuk do të mohojë asgjë nga çfarë është shkruar. E në rast se mohon diçka, atëherë Zoti i jep mundësi të folmes, dëgjimit, shikimit, duarve, këmbëve dhe lëkurës së tij, që ato t'i tregojnë bëmat e tij.

E në Kuranin e madhërishëm, kjo na është shpjeguar gjerësisht.

Allahu i Madhërishëm thotë:

“...dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).” (Kurani, 50:18)

Po ashtu, i Larti thotë:

“...ndonëse mbi ju ka rojtarë (që ju vëzhgojnë), shënues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni.” (Kurani, 82:10-12)

Shpjegimi i këtyre ajeteve:

Zoti i Lartë na tregon se për çdo njeri ka përcaktuar dy engjëj, njëri në anën e tij të djathtë - që të përcjellë dhe të shënojë veprat e mira të tij, si dhe një tjetër në anën e majtë - që të ndjekë e të regjistrojë veprat e liga. Në këto dy ajete, Allahu i Madhërishëm na njofton për vlerën dhe nderin që gëzojnë këta engjëj, po edhe për mundësitë e aftësitë që kanë, nëpërmjet të cilave ata arrijnë që të dinë e të shënojnë çdo veprim të njeriut. Të gjitha këto punë që dalin nga njeriu, Zoti veçse i ka pasur në dijeninë e Tij absolute - ende pa i sjellë ata në ekzistencë; e të gjitha ato, gjenden të shënuara në “El-Leuhû'l-mahfûdh”.

Shehadeti - deklarata islame

"Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, si dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Po ashtu, dëshmoj se xheneti është i vërtetë, xhehenemi është i vërtetë, se Dita e Gjykimit do të ndodhë pashmangshëm e pa dyshim, se Allahu do t'i ringjallë banorët e varreve që t'i marrë në llogari e që t'i shpërblejë dhe se çdo gjë për të cilën na ka treguar Allahu, qoftë në Librin e Tij apo nëpërmjet gjuhës së Profetit të Tij, është e vërtetë!"

O njeri i mençur, të thërras që ta besosh këtë dëshmi dhe ta deklarosh e ta jetësosh - kjo është rruga e shpëtimit.

Kreu i dytë:

Njohja e Profetit

Nëse të vërtetat që i treguam më parë i ke kuptuar, tani është radha të mësosh se Zoti ka dërguar tek ti por edhe tek i gjithë njerëzimi një profet e kumtar dhe ka urdhëruar që t'i bindemi atij e ta pasojmë atë. Zoti na ka treguar se rruga e vetme për njohjen e adhurimit të vërtetë është ajo e pasimit të këtij profeti dhe adhurimi i Zotit sipas shariatit të tij.

Ky profet fisnik është vula e të dërguarve. Ta besojmë e ta ndjekim e kemi obligim hyjnor. Atë e dërgoi Zoti Fuqiplotë për mbarë njerëzit. Ai është Muhamedi, profeti që nuk dinte shkrim e lexim. Në më shumë se dyzet vende në Teurat (Tora) dhe Inxhil, Musai e Isai e kishin paralajmëruar përgëzueshëm ardhjen e këtij profeti. Këto sihariqe lexoheshin nga hebrenjtë dhe të krishterët, mirëpo ata më vonë futën duart në librat e shenjtë dhe i ndryshuan ata!¹

Me këtë profet të çmuar e të dërguar te mbarë njerëzit, Zoti e vulosi vargun e profetëve. Ai është Muhamed ibn Abdu'llah ibn Abdu'l-mutalib el-Hashimi El-Kureshiu. Ishte më fisniku ndër burra, më i virtytshmi në shoqëri, e më fisniku

¹ Shihi këto përgëzime më gjerësisht, ashtu siç janë përmendur në Teurat dhe Inxhil, në librin "El-xhevabu's-şahîh limen beddele dine'l-mesîh", vëll. i parë, vepër e Shejhu'l-Islam Ibn Tejmijes.

Po ashtu, shih: "Hidajetu'l-ħajārâ", të eruditit Muhamed ibn'ul-Kajjim. Po ashtu librin "Es-siretu'n-nebewijje" të Ibni Hishamit, dhe temat përkatëse në librat historikë të Ibn Kethirit e të tjerëve.

në këtë planet. Rridhte nga loza e Profetit Ismail, të birit të Profetit Ibrahim. Ai ﷺ lindi në Mekë, në vitin 570.

Në atë natë në të cilën lindi ai, ndodhën shumë gjëra të jashtëzakonshme. Në çastin kur po dilte nga barku i nënës së tij, në gjithësi u shfaq një dritë e madhe dhe e mahnitshme, ngjarje kjo për të cilën flet historia e kohës. Në atë natë u përmbysën përtokë idhujt e fisit kurejsh, kurse pallati i perandorit të Persisë pësoi një dridhje, ndërsa zjarri i adhurar nga persët u fik për të parën herë, pas dy mijë vitesh që s'ishte shuar fare.¹

Kështu Zoti i njoftonte banorët e Tokës se vula e profetëve lindi. Mision i tij do të jetë shfarosja e idhujve që adhuroheshin përveç Zotit dhe thirrja e popujve, si persët dhe bizantinët, që të adhurojnë vetëm Zotin e Madh dhe të futen në fenë e Tij të vërtetë. E nëse ata zmbrafsen e nuk i përgjigjen kumtarit të Zotit, ai do t'u kundërvihet atyre bashkë me ithtarët e tij, e me ta, pa dyshim, do të jetë ndihma e Zotit. Kjo fe, që është drita e Zotit në Tokë, gjithsesi do të marrë dhenë.

E kjo vërtet ndodhi pasi Allahu e dërgoi Muhamedin ﷺ si profet.

¹ Mehdi Rizkullah në librin e tij "es-Siretu en-Nebeuijjetu a'la dau i el-Mesadiri el-Esliijeti" 1/118 i klasifikon këto ndodhi si mjaft të njohura, por të cilat janë transmetuar në rrugë jo të sakta sipas kritereve të dijetarëve të hadithit. (Shënim i redaktorit).

Allahu e dalloi Profetin Muhamed ﷺ nga profetët e tjerë me disa veçori, prej tyre:

E para:

Ai është vula e profetëve, ndaj nuk do të ketë pas tij ndonjë të dërguar nga Zoti.

E dyta:

Mesazhi i tij i dedikohet mbarë njerëzimit, andaj tërë njerëzimi llogaritet si Umet i Muhamedit - kush i bindet dhe e pason, hyn në parajsë e kush e kundërshton, hyn në ferr.

Të gjithë duhet ta pasojnë atë. Po pra, edhe hebrenjtë dhe të krishterët e kanë obligim që ta ndjekin këtë kumtar të Allahut. Kushdo që nuk i beson atij e s'e pason, ai, në të vërtetë, i ka mohuar vetë Musanë, Isanë dhe mbarë profetët e tjerë, ngase ata, që të gjithë, veçse janë distancuar prej gjithsecilit që nuk e ndjek Muhamedin ﷺ. Kjo ngase Zoti i ka urdhëruar ata që të sihariqojnë njerëzit për ardhjen e tij e t'i thërrasin popujt e tyre që, kur Zoti ta dërgojë atë, ata ta pasojnë dhe t'i besojnë. Feja e këtij profeti është pikërisht ajo fe me të cilën Zoti i dërgonte profetët e Tij të mëparshëm. Fe, që gjatë misionit të këtij profeti fisnik, arriti përsosurinë më të lartë dhe lehtësimet më të gjera. Askujt s'i lejohet që të përqafojë ndonjë fe tjetër përveç Islamit, fesë së shpallur nga Zoti. Me këtë fe të përkryer, Zoti e shfuqizoi çdo fe të mëparshme; kjo fe është e garantuar dhe e ruajtur!

Hebraizmi dhe Krishterimi janë fe të ndryshuara e të zvetënuara; ato më nuk janë ashtu siç i ka shpallur Allahu.

Çdo musliman që e pason Muhamedin konsiderohet edhe ndjekës i Musait, i Isait dhe i profetëve të tjerë.

Kurse në anën tjetër, kushdo që del nga Islami, ai llogaritet mohues dhe përgënjeshtues i Musait, i Isait dhe i mbarë profetëve, edhe nëse pretendon se është prej pasuesve të Musait dhe të Isait!

Andaj, që herët, shumë njerëz prej rabinëve hebrenj, e murgjve të krishterë, nuk ngurruan që t'i besonin Muhamedit صلی الله علیه وسلم e të hynin në Islam.

Mrekullitë¹ e Profetit Muhamed

Dijetarët dhe ekspertët e jetëpërsishkrimit dhe historisë së Profetit Muhamed صلی الله علیه وسلم kanë konkluduar se bëhet fjalë për më shumë se një mijë mrekulli që e dëftojnë vërtetësinë e thirrjes dhe misionit të Profetit صلی الله علیه وسلم.

Prej tyre janë:

- Vula e profetësisë, që ishte në formë lythash në mes të supeve: Muhamedi, i Dërguari i Allahut!

¹ Në Kuran ky nocion quhet shenjë e argument dhe, vërtet, ky emërtim është më i saktë. Mirëpo fjala "mrekulli" ka fituar përdorim, ngase bëhet fjalë për gjëra të jashtëzakonshme

- Në ditët e nxehta të verës, retë i bënin atij hije!
- Guralecët në dorën e tij, i bënin lavdi Zotit, kurse pemët e përshëndetnin atë!
- Profecitë rreth së ardhmes, gjegjësisht rreth periudhës së fundit të Botës; ja, ato dita-ditës po dalin në shesh, një nga një, pikërisht ashtu siç na ka paratreguar!

Të gjitha këto gjëra të paditura për njerëzimin, paraqitja e të cilave nisi pas vdekjes së vulës së profetëve, Muhamedit صلى الله عليه وسلم, -i cili i mësoi ato nga Zoti- janë të shënuara në koleksionet e hadithit dhe në literaturën rreth shenjave të Kijametit, siç janë: "En-Nihaje" e Ibn Kethirit; libri "El-Ehbār el-mushā'ah fī eshrā'i's-sāah" dhe kapitujt rreth trazirave dhe qedereve në koleksionet e hadithit. Këto mrekulli kanë ngjashmëri të madhe me mrekullitë e profetëve të mëparshëm.

Mirëpo ai ka një mrekulli të veçantë, gjegjësisht një mrekulli logjike të përhershme, të cilën Zoti nuk ia dha askujt prej profetëve, përveç tij. Ajo mrekulli është Kurani i Madhërishëm - Fjala e Zotit, të cilën e garantoj vetë Ai, andaj dora e falsifikimit nuk mbërrin dot te ky libër, e madje, edhe nëse dikush përpiket ta ndryshojë qoftë vetëm një shkronjë, ai menjëherë zbulohet. Bëhet fjalë për miliona ekzemplarë të këtij libri që gjenden në duart e muslimanëve, e të cilët janë në përputhshmëri të plotë me njëri-tjetrin. Ndryshe nga ekzemplarët e Teuratit (Torës) dhe Inxhilit (Ungjilit); ata janë të shumtë dhe të ndryshëm nga njëri-tjetri. Kjo ngase hebrenjtë dhe të krishterët, të

cilët e patën për detyrë që t'i ruanin ata libra, i futën në ta duart e ndryshimit, shtrembërimit dhe falsifikimit. E sa i përket ruajtjes së Kuranit, Zoti nuk e ngarkoi askënd me këtë detyrë, mirëpo e garantoj vetë Ai, madhëruar qoftë!

Ashtu siç i Madhërishmi thotë:

“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.” (Kurani, 15:9)

Argumenti logjik dhe kuranor që tregon se Kurani është fjalë e Allahut, kurse Muhamedi Profet i Allahut

Prej argumenteve logjike që flasin për këtë të vërtetë, pra se Kurani është fjalë e Allahut dhe se Muhamedi صلی الله علیه وسلم është Profet i Tij është sfida që Zoti ua ka bërë jobesimtarëve kurejshë, atëherë kur ata, e përgënjeshtroan Muhamedin صلی الله علیه وسلم njëjtë sikurse përgënjeshtroesit e mëparshëm të profetëve, duke thënë se Kurani nuk është fjalë e Zotit. Mirëpo Zoti i vuri në sfidë: sillni në mundshi diçka sikurse ai, por ata nuk patën mundësi të bënin diçka të tillë, edhe pse ishte në gjuhën e tyre, ishin populli më elokuent, e në mesin e tyre kishin gojëtarët më të shquar e poetët më të dalluar. Pastaj vijoi sfida e radhës: sillni në mundshi vetëm dhjetë kaptina sikur ato të Kuranit, por sërish nuk patën mundësi. Pastaj sfida e fundit ishte: sillni në mundshi qoftë edhe vetëm një kaptinë si ato kuranore, por prapë nuk patën mundësi dhe kështu Zoti e nxori në pah paaftësinë e tyre.

E pra, as njerëz e as xhinë nuk kanë mundësi të sjellin diçka si Kurani, edhe sikur të ndihmoheshin ndërmjet vete.

I Larti tha:

“Thuaj: “Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhinët për të hartuar një Kuran të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri-tjetrin.” (Kurani, 17:88)

Sikur Kurani të kishte qenë prej fjalëve të Muhamedit apo të dikujt tjetër prej njerëzve, atëherë edhe dikush tjetër prej gojëtarëve dhe elokuentëve do të kishte mundësi të sillte diçka të tillë. Mirëpo bëhet fjalë për fjalën e Zotit, vlera dhe lartësia e së cilës kundrejt fjalëve të njerëzve është si vlera e vetë Zotit kundrejt njerëzve.

Ashtu sikur që Ai nuk ka ndonjë shembull e përngjasim, njashtu edhe fjala e Tij nuk ka ndonjë të ngjashëm e krahasim. Kështu na bëhet e qartë se Kurani është fjalë e Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij; kjo ngase me fjalë të Zotit nuk paraqitet askush përpos një profeti të dërguar nga Ai.

Po ashtu, Allahu i Lartësuar thotë:

“Muhamedi nuk është babai i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve; Allahu është i Gjithëdijshtëm për çdo gjë.” (Kurani, 33:40)

Zoti i Lartë thotë:

“Ne të kemi dërguar ty (o Muhamed) vetëm si sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues për të gjithë njerëzimin, por shumica e njerëzve nuk dinë.” (Kurani, 34:28)

Po ashtu Allahu i Madhërishëm thotë në Kuran:

“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.” (Kurani, 21:207)

Kuptimi i përgjithshëm i këtyre ajeteve:

Në ajetin e parë, Allahu na tregon se Muhamedi صلی الله علیه وسلم është dërguar me mision profetik të mbarë njerëzimi, si dhe na dëfton që, me këtë profet i jepet fund misioneve profetike. Gjithashtu, na tregon se ai ishte përzgjedhja e duhur për këtë detyrë madhështore – që të bartë mesazhin hyjnor dhe të jetë vulë e profetëve. Në ajetin vijues, Allahu na flet edhe më shumë për misionin mbarënjërzor të Profetit صلی الله علیه وسلم; profet për të gjitha racat dhe për të gjithë popujt. Allahu na e bën me dije gjithashtu se shumica e njerëzve nuk e njohin të vërtetën dhe se për këtë arsye kanë mohuar dhe kanë devijuar, duke mos e ndjekur rrugën e Profetit Muhamed صلی الله علیه وسلم.

Në ajetin e tretë, Zoti i flet kumtarit të Tij, Muhamedit صلی الله علیه وسلم; i tregon se ai është mëshira e Zotit për mbarë botët. Pra, ai është mëshira që Zoti Bujar e ka lëshuar për ne; kush e beson dhe e pason atë, ai kështu e ka pranuar mëshirën e Allahut dhe për të është parajsja, e kushdo që nuk e beson Muhamedin dhe nuk e ndjek atë, ai kështu e ka refuzuar

mëshirën e Zotit të tij dhe për të janë zjarri dhe ndëshkimi i dhimbshëm.

Një thirrje për ta besuar Allahun dhe Profetin e Tij

O njeri i arsyeshëm, besojë Allahun për Zot e të Dërguarin e Tij Muhamedin për profet; pasoje atë dhe vepro sipas proklamates me të cilën u dërgua nga Zoti, gjegjësisht sipas fesë islame, burimi i së cilës është Kurani madhështor – fjala e Zotit, dhe hadithet autentike – fjalët e vulës së profetëve, Muhamedit ﷺ. Profeti e kishte një mbrojtje të veçantë nga Zoti; ai nuk urdhëronte asgjë tjetër përpos urdhëresave që i jepte Zoti, sikundër që nuk ndalonte nga asnjë send, përveç nga ajo që e ndalonte Zoti. Thuaj pra singërisht: Allahu është Zoti dhe Hyjnia ime. Thuaj gjithashtu: Muhamedi është i Dërguari i Allahut dhe atë e ndjek! Kjo është udha e vetme e shpëtimit! Na shoqëroftë lumturia përherë e përjetë!

Kreu i tretë:

Njohja e fesë së vërtetë – Islamit

Nëse arsyeja jote e shëndoshë i kapi këto të vërteta, pra, se Allahu i Lartë është Zoti yt - i Cili të solli në ekzistencë dhe i Cili të furnizon pareshtur, se Ai është i Vetmi Zot i Vërtetë e i Paortak, se ta adhurosh Zotin është detyrë e pashmangshme, se Muhamedi është Profeti që Zoti e dërgoi tek ti dhe te mbarë njerëzimi. Pra, tani mësoje se besimi yt në Zotin e Madhërishëm dhe në Profetin e Tij, Muhamedin صلى الله عليه وسلم mund të konsiderohet i vlefshëm e i pranueshëm vetëm nëse vërtet e beson, e përqafton dhe e jetëson fenë Islame, ngase Zoti këtë fe e përzgjedhi për ne, na urdhëroi ta jetësojmë dhe me të i dërgoi të gjithë profetët, sikurse edhe Muhamedin – vulën e profetëve

صلى الله عليه وسلم .

Përkufizimi dhe paraqitja e Islamit

Vula e profetëve dhe kumtari i Zotit për mbarë njerëzit thotë:

"Islami është të dëshmosh se s'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, ta falësh namazin, ta japësh zekatin, ta agjërosh ramazanin dhe, nëse ke mundësi, ta bësh haxhin në Qabe!"¹

¹ Shënon Buhariu dhe Muslimi.

Pra, Islami është feja botërore, të cilën Zoti e bëri të detyrueshme për mbarë njerëzit. Këtë fe e besonin të gjithë profetët, të cilët sheshazi e proklamnin dorëzimin e tyre ndaj Zotit, i Cili shpalli prerazi se nuk pranon asnjë fe tjetër përveç Islamit!

I Larti ka thënë:

“Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami.” (Kurani, 3:19)

Po ashtu, Allahu i Madhërishëm thotë:

“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.” (Kurani, 3:85)

Kuptimi i përgjithshëm i këtyre dy ajeteve:

Zoti i Lartë na tregon se fe e vetme tek Ai është Islami, kurse në ajetin tjetër na tregon se nuk e pranon asnjë fe tjetër përveç Islamit.

Sikurse na tregon se në botën tjetër, askush përpos muslimanëve nuk do të jetë i lumtur; e ata që vdesin në një fe tjetër përveç Islamit, do të jenë të humbur në botën tjetër dhe ata i pret dënimi me zjarr.

Për këtë arsye, të gjithë profetët e proklamnin Islamin - dorëzimin ndaj Zotit, dhe distancoheshin nga gjithkush që nuk i dorëzohej Atij. Cilido hebre apo i krishter që dëshiron shpëtim e lumturi, le të hyjë në Islam dhe le ta ndjekë Profetin e kësaj feje - Muhamedin صلى الله عليه وسلم që si rrjedhim, vërtet, të jetë një pasues i denjë i Musait e i Isait, -paqja

qoftë mbi ta!-. Kjo ngase Musai, Isai, Muhamedi dhe të gjithë profetët e Zotit, ishin muslimanë dhe propagandues të Islamit, ngase kjo fe është feja e Zotit, i Cili i dërgoi ata profetë që të kumtonin Islamin te njerëzit. Tani e tutje, pasi Allahu e ka dërguar me mision Profetin e Tij, Muhamedin صلى الله عليه وسلم e deri në fundin e kësaj bote, askush nuk mund të konsiderohet musliman - i dorëzuar ndaj Zotit, e as që ia pranon Allahu dikujt një pretendim të tillë, përveçse nëse e beson vulën e profetëve - Muhamedin صلى الله عليه وسلم si profet të dërguar nga Zoti, e pason atë dhe vepron me mësimet e shpallura nga Zoti në Kuran.

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”. (Kurani, 3:31)

Kuptimi i përgjithshëm i ajetit:

Allahu e urdhëron të Dërguarin e Tij, Muhamedin صلى الله عليه وسلم që t’u thotë atyre që e pretendojnë dashurinë e Zotit: nëse ju e doni vërtet Allahun, atëherë ndiqmëni mua, e kështu do të fitoni dashurinë e Allahut. Kjo ngase Allahu nuk ju do e as që jua falë mëkatet, përveç nëse i besoni Profetit të Tij, Muhamedit صلى الله عليه وسلم dhe e pasoni atë.

Ky Islam, me të cilën u dërgua Muhamedi صلى الله عليه وسلم nga Zoti i Madhërishëm, te mbarë njerëzit, pikërisht ky është Islami i plotë, gjithëpërfshirës, i lehtë e tolerant, të cilin e përsosi

Zoti dhe e përzgjedhi për robërit e Tij, prej të cilëve nuk e pranon asnjë fe tjetër. Këtë Islam e sihariqonin dhe e besonin të gjithë profetët.

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj.” (Kurani, 5:3)

Kuptimi i përgjithshëm:

Teksa Profeti Muhamed صلى الله عليه وسلم ishte në Arafat - në Mekë, duke kryer ritualet e haxhit të lamtumirës - nga fundi i jetës së tij, periudhë kjo kur feja e vërtetë kishte marrë dhenë, ndërsa zbritja e Kuranit veçse ishte në përfundim e sipër, Zoti i shpalli këtë ajet fisnik.

Zoti Fuqiplotë po na tregon se me dërgimin e Profetit Muhamed صلى الله عليه وسلم dhe me zbritjen e Kuranit të madhërishëm e përkreu fenë dhe e përsosi mirësinë hyjnore. Na tregon se vetëm këtë fe Ai e pranon e assesi ndonjë tjetër.

Gjithashtu, na tregon se Islami me të cilin erdhi i Dërguari i Tij, Muhamedi صلى الله عليه وسلم është një fe e përsosur, gjithëpërfshirëse dhe e përshtatshme për çdo kohë, vend e popull; është feja e diturisë, e lehtësimit, e drejtësisë dhe e mirësisë. Kjo fe është sistemi më i përkryer që i përgjigjet çdo nevojë jetësore të njeriut, pra, përmbush shpirtin dhe organizon jetën qytetare. Kjo ngase ajo vepron me metodologjinë më të drejtë në të gjitha segmentet e jetës, që nga pushteti, gjyqi, politika e deri te çështjet sociale e ekonomike. Po pra, ajo mbarështon jetën në tërësi, sikurse

siguron edhe lumturi në jetën pas vdekjes, në jetën e amshimit.

Shtyllat e Islamit

Islami i plotë, me të cilin e ka dërguar Allahu Profetin e Tij, Muhamedin ﷺ është i ndërtuar mbi pesë shtylla. Njeriu nuk bëhet dot musliman i vërtetë, përveçse kur t'i besojë e t'i zbatojë ato:

1. Të dëshmojë se s'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut;
2. Ta falë namazin;
3. Ta japë lëmoshën e detyrueshme (zekatin);
4. Ta agjërojë muajin ramazan;
5. Ta bëjë pelegrinazhin (haxhin) në shtëpinë e shenjtë – Qabe, nëse ka mundësi rruge;

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

"Islami është ngritur mbi pesë shtylla: dëshmia se s'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit - lëmoshës së detyrueshme, haxhi - pelegrinazhi tek Shtëpia e Shenjtë dhe agjërimi i muajit ramazan!"¹

¹ Shënon Buhariu dhe Muslimi.

Këto shtylla kanë shtrirje të gjerë në argumentet e Kuranit Famëllartë.

Shtylla e parë: Dëshmia se s'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij

Kjo dëshmi ka një domethënie, të cilën çdo musliman duhet ta dijë e ta jetësojë. Ai që vetëm e shqipton atë, mirëpo pa e kuptuar dhe pa e jetësuar, në të vërtetë, ai s'përfiton gjë nga ky deklaram gojor. Domethënia e fjalës "Lã ilãhe il-lall-llãh" - nuk ka hyjni përveç Allahut është: nuk ka në Tokë e as në qiell ndonjë të adhuruar që adhurohet me të drejtë përveç të vetmit Allah, pra, Ai është Hyjnia e vërtetë, kurse çdo hyjni përveç Tij është një hyjni e kotë dhe e rrejshme. Fjala "ilãh" do të thotë: i adhuruar.

Gjithsecili që adhuron dikë tjetër përveç Zotit, ai është mohues dhe idhujtar, edhe nëse i adhuruari i tij është një profet apo evlia i devotshëm. Ky gjykim bie edhe mbi atë që idhujtarinë e vet mundohet ta justifikojë si përpjekje për t'u afruar te Zoti dhe për të gjetur ndërmjetësues tek Ai. Profeti Muhamed ﷺ ishte në armiqësi të hapët me idhujtarët e kohës së tij, të cilët besonin dhe vepronin me këtë argumentim dhe logjikë të kotë. Le ta dimë mirëfilli se afrimi tek Allahu i Lartë dhe gjetja e ndërmjetësimit nuk bëhet me doke idhujtareske, duke i kushtuar adhurime dikujt tjetër përveç Allahut, por me mënyra të ligjshme fetare, siç është afrimi nëpërmjet emrave dhe cilësive të Zotit, veprave të mira si namazi, lëmosha, përmendja e Zotit, lufta në rrugë

të Tij, agjërimi, haxhi - pelegrinazhi, mirëbërësia ndaj prindërve etj., si dhe nëpërmjet lutjes që një besimtar i gjallë e bën për vëllanë e tij.

Adhurimi është shumëllojësh:

Ndër to është lutja, domethënia e së cilës mund të përkufizohet siç vijon: të dëshirosh dhe të kërkosh diçka që të nevojitet e të cilën s'e realizon dot askush përpos Zotit, siç është zbritja e shiut, shërimi i të sëmurit, largimi i qedereve të rënda (të cilat s'i largon dot krijesa), fitimi i parajsës, shpëtimi nga ferri, dhurimi i fëmijëve, furnizimi, lumturia e të ngjashme.

Pra, asnjë nga këto të lartpërmendurat nuk kërkohen nga dikush tjetër përpos Allahut, e nëse dikush lyp diçka nga këto prej dikujt prej krijesave, qoftë krijesë e gjallë apo e vdekur, ai kështu e ka adhuruar atë. Allahu i Lartësuar, duke i urdhëruar robërit e Tij që ta lusin vetëm Atë e duke iu treguar se lutja është një adhurim dhe se kushtimi i saj dikujt tjetër përpos Allahut është një rrugë që shpie në ferr, thotë:

“Zoti juaj ka thënë: “Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar”!” (Kurani, 40:60)

Allahu i Lartë na tregon se të gjithë ata të cilëve u bëhen lutje përveç Zotit Fuqiplotë, në të vërtetë janë vetëm krijesa, që nuk kanë kurrfarë mundësie për t'i bërë dobi a dëm askujt, madje edhe nëse është profet apo njeri i mirë:

“Thuaj: “Thirrini ata që ju i hyjnizoni përveç Tij! Ata nuk mund t’jua largojnë të keqen e as nuk mund ta hedhin atë tjetërkund”. (Kurani, 17:56) dhe ajeti në vijim:

Allahu i Lartësuar thotë: “Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt krahas Allahut!” (Kurani, 72:18)

Po ashtu, prej adhurimeve janë zotimi, flijimi i kafshëve nëpërmjet therjes apo çfarëdo sakrifice tjetër me qëllim adhurimi.

Këto adhurime, pra afrimi i sakrificave e të ngjashme, bëhen vetëm për Zotin, e për askënd tjetër përveç Tij. Kushdo që ther ndonjë kafshë për dikë tjetër përveç Allahut, qoftë për ndonjë varr a xhin, ai kështu e ka adhuruar dikë tjetër përveç Allahut e si rrjedhim e meriton mallkimin e Tij.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurbandi im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij”. (Kurani, 6:162-163)

Po ashtu, Profeti ﷺ thotë:

"Allahu e lëshoftë mallkimin e Tij mbi atë që ther kafshë për dikë tjetër përveç Allahut!"¹

¹ Hadith sahih - autentik; shënon Muslimi.

Nëse dikush zotohet në dikë që, nëse më realizohet një aksh dëshirë, unë kam për të dhënë një lloj lëmoshe, ai kështu bie në idhujtari, ngase është zotuar në një krijesë, kurse zotimi është lloj adhurimi, e adhurimi nuk i takon askujt përpos Zotit. Sa i përket zotimit të pranueshëm në Islam, ai parafrazohet duke thënë: “Jam zotuar te Zoti që, nëse më plotësohet dëshira, kam për të dhënë lëmoshë e kam për të bërë adhurime për Zotin!”

Gjithashtu, prej llojeve të adhurimit është: të kërkosht ndihmë dhe mbrojtje gjatë vështirësive, nevojave dhe krizave.

Në këto raste e në këto nevoja, askujt përpos Zotit Fuqiplotë nuk i kërkohet ndihmë e as mbrojtje.

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” (Kurani, 1:5)

Po ashtu, Allahu i Lartë thotë:

“Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit, që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar.” (Kurani, 113:1-2)

Po ashtu, Profeti ﷺ thotë:

"Nuk lypset ndihmë nga unë gjatë vështirësive, porse vetëm nga Zoti!"¹

¹ Hadith sahih - autentik; shënon Et-Taberaniu.

Po ashtu, ai ﷺ ka thënë:

"Kur të kesh ndonjë kërkesë, kërkoje nga Allahu, sikurse kur të duhet një ndihmesë, lype atë tek Ai!"¹

Ke të drejtë që të kërkoresh ndihmë nga njeriu që e ke pranë, nëse bëhet fjalë për diçka përbrenda mundësive njerëzore. Mirëpo sa i përket kërimit të strehës e mbrojtjes, ajo duhet të kërkohet vetëm prej Allahut. Është e kotë t'i kërkoresh ndihmë ndonjë të vdekuri apo dikujt që s'është afër teje, ngase ata nuk kanë kurrfarë mundësie, edhe nëse janë profetë, evlia apo engjëj.

Gajbin - dijen e fshehtë, askush nuk e di përpos Zotit Fuqiplotë. Gjithsecili që pretendon se e njeh dijen e të padukshmes, ai është një jobesimtar që doemos duhet përgënjeshtruar. Nëse ai parathotë diçka dhe ashtu ndodh, kjo thjesht është një ko incidencë - përputhje e rastit.

Profeti Muhamed ﷺ thotë:

"Kush shkon tek një falltar a fatthënës dhe i beson atij në atë që ai e thotë, veçse e ka mohuar atë që i është shpallur Muhamedit!"²

Gjithashtu, prej llojeve të adhurimit është t'i mbështetesh Zotit, të shpresosh tek Ai e t'i përulesh Atij me frikë-respekt. Pra, njeriu duhet të mbështetet vetëm tek Allahu Fuqiplotë,

¹ Hadith sahih - autentik; shënon Tirmidhiu.

² Shënon Imam Ahmedî dhe Hakimî.

t'i mbajë shpresat vetëm tek Ai dhe ta madhërojë vetëm Atë me frikë e respekt.

Një pjesë e madhe e njerëzve që i përshkruhen Islamit bëjnë praktika të shumta idhujtarie; i lusin njerëzit, të gjallë qofshin ata apo të vdekur, duke iu sjellë vërdallë varreve të tyre. Duke bërë adhurime për dikë tjetër përpos Zotit, ata asesi nuk e meritojnë emrin 'musliman', edhe nëse e pretendojnë Islamin, thonë: "La ilahe ilAllah, Muhamedu'r-Resul'ull-llah", e falin namazin, agjërojnë dhe e kryejnë pelegrinazhin në Mekë.

Allahu i Lartësuar thotë:

"Me të vërtetë, të është shpallur ty (o Muhamed), si dhe atyre që kanë qenë para teje: "Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër (në adhurim), me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit." (Kurani, 39:65)

Gjithashtu, Allahu thotë:

"Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t'ia ndalojë Xhenetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës." (Kurani, 5:72)

Allahu i Madhërishëm e ka urdhëruar kumtarin e Tij, Muhamedin صلی الله علیه وسلم që t'u thotë njerëzve:

"Thuaj: "Unë jam vetëm një njeri (vdekatar) si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm. Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të

mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!” (Kurani, 18:110)

Këta njerëz të padijshëm ishin përherë pre e mashtrimeve të dijetarëve të së keqes e të devijimit, të cilët fort mirë i dinë shumë degë të fesë, por nuk e njohin bazën e saj – teuhidin, njësimin e Zotit, që është çështja më e themeltë e fesë, e për pasojë, në emër të ndërmjetësimit, i thërrasin njerëzit në idhujtari, duke u bazuar në interpretime të kota që u bëjnë teksteve joautentike fetare e në ëndrra me frymëzim djallëzor e kotësira të ngjashme, të cilat i gjen të shënuara nëpër librat e tyre, në të cilët janë përpjekur që të arsyetojnë idhujtarinë e tyre – adhurimin e bërë për dikë tjetër përveç Allahut. Ata shkuan zvarrë pas djallit dhe epshit, si dhe i ndoqën qorrazi baballarët e tyre, siç ishte zakoni i idhujtarëve të hershëm.

Ajo "el-uesiletu", që Zoti na urdhëroi që, nëpërmjet saj të përpiqemi të afrohemi tek Ai: **“...përpiquni që t'i afroheni Atij me vepra të mira...”** (Kurani, 5:35) është tërësia e veprave të mira, si monoteizmi - njësimi i Allahut, namazi, lëmosha, agjërimi, haxhi, lufta, urdhërimi në të mirë, ndalimi nga e keqja, mirëshkuesia me të afërmit e të ngjashme. E sa i përket lutjes dhe kërimit të ndihmës nga i vdekuri, gjatë situatave të vështira, ato në të vërtetë janë adhurime të bëra për dikë tjetër përveç Allahut.

Ne besojmë që profetët dhe njerëzit e mirë, nëse Zoti u jep leje, do të ndërmjetësojnë për besimtarët, mirëpo ky ndërmjetësim nuk kërkohet nga të vdekurit, ngase ajo i përket vetëm Zotit – vetëm me lejen e Tij ndodh. Ndaj,

monoteisti e kërkon atë vetëm nga Allahu, duke thënë: “O Allah, bëji profetin dhe njerëzit e mirë ndërmjetësues për mua!”, e nuk thotë: “O filan, ndërmjetëso për mua!”, ngase bëhet fjalë për njeri të vdekur, e prej të vdekurit nuk kërkohet asgjësend.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Thuaju: “Ndërmjetësimi është i gjithi në duart e Allahut; Atij i takon pushteti i qiejve dhe i Tokës e pastaj tek Ai do të ktheheni”. (Kurani, 39:44)

Po ashtu, prej risive që bien ndesh me Islamin e të cilat i ka ndaluar vetë i Dërguari i Zotit në hadithe autentike: ndërtimi i faltoreve mbi varre, ndriçimi i varreve me fenerë, ndërtimet, skulpturat, shënimet dhe perdet mbi varre, si dhe namazi në varreza; të gjitha këto praktika i ka ndaluar Profeti ﷺ, ngase bëhet fjalë për rrugë që shpien në idhujtari.

Ajo çfarë bëjnë disa injorantë nëpër varre e tyrbe, duke bërë tavaf – rrethrotullim e duke iu lutur të vdekurve për hallet e tyre, pa dyshim që është një idhujtari e pacipë dhe devijim i qartë. Këto paganizma sot mund t’i shohim në Egjipt, te varri i El-Bedeviut dhe Es-Sejdetu Zejneb; në Irak, te varri i El-Xhejlaniut, po edhe te varret që mendohet të jenë të familjarëve të Profetit ﷺ në qytetet Nexhef e Qerbela.

Për shkak të këtyre dogmave dhe praktikave pagane, këta injorantë konsiderohen idhujtarë e të devijuar, edhe nëse

pretendojnë se janë muslimanë, falen, agjërojnë, kryejnë haxhin dhe e shqiptojnë deklaratën e Islamit. Në të vërtetë, pohimi i dëshmisë – shehadetit bën punë vetëm atëherë kur ajo kuptohet mirëfilli dhe vihet në praktikë. Filli i hyrjes në Islam është dëshmia, zhbërja e së cilës ndodh si pasojë e idhujtarisë, mohimit të detyrave fetare dhe ndjekjes së një feje tjetër, përveç Islamit.

Profetët dhe evliatë – njerëzit e mirë¹, nuk kanë të bëjnë asgjë me këta injorantë që i drejtohen atyre me lutje; në të vërtetë, detyra e profetëve ishte që t'i urdhëronin njerëzit që ta adhuronin vetëm Zotin dhe të braktisnin çdo të adhuruar tjetër, qoftë profet, evlia e të tjerë.

Dashuria ndaj Profetit dhe njerëzve të mirë – evlilave nuk manifestohet nëpërmjet adhurimit të tyre, çka, në të

¹ Evliatë – njerëzit e mirë janë besimtarë të përkushtuar që e veçojnë Zotin me adhurim dhe i binden Atij me devotshmëri. Pasimi i përpiktë i Profetit ﷺ është tipar i pashmangshëm i tyre. Disa prej tyre kanë nam ndër njerëz, qoftë për shkak të diturisë apo përpjekjeve fisnike, por disa jo. Mirëpo asnjëri prej tyre nuk pranon që të shenjtërohet nga ana e njerëzve. Në të vërtetë, asnjë prej evliave të vërtetë nuk i vë vetvetes emrin “evlia” – njeri i mirë, madje përkundrazi, ata përherë janë vetëkritikë. Ata nuk kanë ndonjë veshje të dallueshme, as ndonjë pamje të veçantë; ata ndjekin vetëm Profetin ﷺ. Çdo musliman monoteist e pasues i Profetit ﷺ për aq sa është i devotshëm e i sinqertë, llogaritet prej evliave. Pra, mbaje në mend se gjithë ata mashtrues që pretendojnë se janë evlia dhe vishen në një formë të veçantë që t'i shenjtërojnë njerëzit, s'janë gjë tjetër përpos gënjeshtarë!

vërtetë, ky gjest s'është gjë tjetër përpos armiqësi ndaj tyre. Dashurinë tonë për ta ne mund ta shprehim nëpërmjet pasimit të tyre. Muslimani i vërtetë i do profetët dhe evliatë, por nuk i adhuron ata, por e adhuron vetëm Zotin e Lartësuar. Ne besimtarët besojmë bindshëm se ta duash Profetin ﷺ është një detyrë e pashmangshme për të gjithë ne, madje ajo dashuri duhet të jetë sipër dashurisë sonë për vetveten, familjen, fëmijën e mbarë njerëzit.

Pala e shpëtuar:

Numri i muslimanëve është i madh, porse në të vërtetë, numri i atyre që janë të denjë është i vogël. Arrin në shtatëdhjetë e tre numri i sekteve dhe i grupeve që i përshkruhen Islamit, që si komunitet në tërësinë e vet përfshin mbi një miliard ithtarë¹, mirëpo nga ato grupe të shumta, vetëm njëra është pala e denjë islame. Ata janë besimtarët që e njësojnë Zotin e Madhërishëm dhe që ecin në rrugën e Profetit Muhamed ﷺ dhe të shokëve të tij, si në çështjet e akides (besimit), veprave të mira, e në të tjera çështje të fesë.

Ashtu siç ka treguar Profeti ﷺ në fjalën e tij:

"Hebrenjtë janë përçarë në shtatëdhjetë e një grupe; të krishterët në shtatëdhjetë e dy; kurse ky Umet do të përçahet në shtatëdhjetë e tri grupe. Që të gjitha do të jenë në zjarr, përveç njëres."

¹ D.m.th. kur është shkruar ky libër.

Sahabët thanë: "Cila është ajo, o i Dërguari i Allahut?!"

Ai tha:

"Ata që do të jenë në atë (rrugën) që jam unë dhe shokët e mi sot!"¹

Profeti ﷺ dhe shokët e tij, ishin në një rrugë të qartë, e besonin dhe e jetësonin domethënien e fjalës “La ilahe ilAllah, Muhamedu’r-resul’ull-Ilah”; lutjet, kurbanet, zotimet, kërkimin e ndihmës në vështirësi e të strehës në nevojë, i kishin vetëm për Zotin e Madhërishëm, për të Cilin besonin se vetëm Ai mund të sjell dëm e dobi; shtyllat e Islamit i praktikonin dëlirësisht vetëm për Zotin; besonin në engjëjt, librat, profetët, ringjalljen, llogarinë, parajsën, ferrin, parapërcaktimin hyjnor – qoftë për mirë a për keq; e në të gjitha segmentet e jetës së tyre, me plot pajtim e bindje e kërkonin gjykimin e Kuranit dhe të traditës profetike – Sunetit; kishin miqësi me besimtarët – miqtë e Zotit e armiqësi me armiqtë e Tij; me ngulm përpiqeshin që ta përhapnin fenë e vërtetë, duke mënjanuar çdo pengesë në këtë rrugë; besonin se kundrejt prijësit të muslimanëve duhet të sillen me besnikëri e dëgjueshmëri, atëherë kur ai i urdhëron me diçka të mirë; e kishin parim që, kudo që të jenë, ta thonë të vërtetën; i donin dhe i nderonin familjen, bashkëshortet dhe shokët e Profetit ﷺ; i radhisnin e i donin shokët e tij varësisht vlerës që kishin, mirëpo për të gjithë luteshin që, pajtimi dhe kënaqësia e Zotit të jenë me ta; e kishin rregull që, nuk duhet t’i zgafullojnë problemet

¹ Shënon Buhariu dhe Muslimi.

që kishin ndodhur në mes të sahabëve, si dhe të mos i besojnë fjalëve të kota të thëna kundrejt tyre, të dala nga gjuhë hipokritësh që synonin përçarjen e muslimanëve, fjalë të cilat ndonjëherë i kanë bartur edhe dijetarët apo historianët me qëllim të mirë, edhe pse edhe kjo ishte gabim, sepse ato fjalë s'kanë merituar asnjë faqe të historisë!

E ata që pandehin se janë Ehlu'l-bejt – familjarë të Profetit صلی الله علیه وسلم dhe quhen „Es-Sāde“, kanë për detyrë që të sigurohen se vërtet i përkasin kësaj gjenealogjie familjare apo jo, ngase Allahu e ka mallkuar atë që s'i atribuohet babait të vërtetë. Nëse vërtet ata janë rrjedhë e këtij trangu familjar, doemos duhet që ta ndjekin denjësisht Profetin صلی الله علیه وسلم, duke e veçuar Zotin me besim e adhurim, duke braktisur mëkatet, duke i ndaluar njerëzit nga zakonet e kota që bëhen kundrejt kësaj familjeje, si puthja e gjunjëve dhe e këmbëve, si dhe duke mos u veçuar nga shoqëria muslimane me ndonjë veshje speciale, ngase këto bien ndesh me udhën e Profetit صلی الله علیه وسلم. Ta dimë mirë që, vlera e njeriut te Zoti i Madhërishëm, mund të lartësohet vetëm në sajë të devotshmërisë! E Allahu e lavdëroftë dhe e bekoftë Profetin Muhamed!

Pushteti dhe ligjësimi i takojnë vetëm Allahut – aty ku është ligji i Tij, aty është drejtësia, mëshira dhe vlera

Prej domethënieve të fjalës "Lā ilāhe il-lall-llāh" që doemos duhet të besohen e të jetësohen është: se e drejta e gjykimit dhe e ligjësimi i përkasin vetëm Zotit Fuqiplotë. Askujt prej njerëzve s'i lejohet që të ligjësojë kode në kundërshtim me ligjin apo urdhrin e Allahut. Muslimani nuk e ka të lejuar që të gjykojë me ligj tjetër, përveç ligjit të Allahut. Ai nuk guxon që të jetë i kënaqur e i pajtuar me legjislacionin që e kundërshton sheriatin e Allahut. Askujt s'i lejohet që të lejojë atë që Allahu e ka ndaluar apo ta ndalojë atë që Allahu e ka lejuar; e kushdo që vepron kësisoj me vetëdëshirë, duke e synuar kundërshtimin, ai është jobesimtar.

Allahu i Madhërishëm thotë:

“Kushdo që nuk gjykon sipas asaj që ka shpallur Allahu, ai është mohues i vërtetë.” (Kurani, 5:44)

Detyra e profetëve që thirrja e njerëzve për te fjala e teuhidit: "Lā ilāhe il-lall-llāh" dhe domethënia e saj është të adhurohet vetëm Allahu e të braktiset adhurimi dhe ligji i gjithkujt tjetër përveç Tij.

Nëse e lexojmë Kuranin me meditim e vëmendje, sigurisht që do të bindemi se kjo që shpjeguar është më se e vërtetë! Zoti e ka shpjeguar qartë lidhjen njeri-Zot dhe lidhjen njeri-njeri. Lidhja me Zotin manifestohet nëpërmjet adhurimit: të gjitha adhurimet i kushtohen vetëm Atij, madhëruar qoftë, dhe askujt tjetër! Kurse lidhja e njeriut

me profetët dhe njerëzit e mirë është lidhje pasimi, po edhe lidhje dashurie, e cila buron nga dashuria për Zotin. E sa i përket lidhjes së besimtarit me mohuesit dhe armiqët e Zotit, ajo është lidhje hasmërie, ngase ata i urren Zoti; mirëpo përskej kësaj, ai përpiqet me çdo mënyrë që t'i thërret për te e vërteta dhe bindja ndaj Krijuesit të gjithësisë, dhe të largojë pengesat që shfaqen gjatë kësaj thirrjeje. Këto janë domethëniet e fjalës "Lā ilāhe il-llah", të cilat duhet t'i dijë e t'i jetësojë çdo musliman, në mënyrë që të jetë musliman i vërtetë.

Domethënia e dëshmisë se Muhamedi është i Dërguari i Allahut:

Kuptimi i dëshmisë se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, mund të përkufizohet siç vijon: ta dish dhe ta besosh se Muhamedi është i Dërguari i Allahut te mbarë njerëzit; se ai është rob e nuk duhet të adhurohet; se ai është profet që nuk përgënjeshtrohet, por duhet që të dëgjohet e të pasohet; se çdo besimtar që i bindet atij e meriton parajsën, sikurse çdo kundërshtues i tij e meriton ndëshkimin në ferr! Gjithashtu, ta dish e ta besosh që, në çështjet e adhurimit, të jetës publike, pushtetit, lejesave e ndalesave e kështu me radhë, jemi të obliguar t'i nënshtrohemi vetëm ligjit dhe proklamatës së Profetit Muhamed ﷺ, i cili transmeton atë që i shpall Zoti i tij. Zoti i Madhërishëm thotë:

“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.” (Kurani, 59:7)

Po ashtu, Zoti i Lartë thotë:

“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.” (Kurani, 4:65)

Kuptimi i këtyre dy ajeteve: Në vargun e parë kuranor, Allahu i urdhëron muslimanët që, ndaj të gjitha urdhëresave dhe ndalesave të të Dërguarit të Tij, Muhamedit صلى الله عليه وسلم ata të tregohen të dëgjueshëm e të bindur! Kjo ngase ai urdhëron dhe ndalon sipas urdhëresave dhe ndalesave të Allahut! Ndërsa në ajetin tjetër, Zoti betohet në qenien e Tij të shenjtë se besimi i një njeriu mund të jetë i vlefshëm vetëm atëherë kur edhe gjykimin për ngatërresat e tij me njerëzit, e kërkon te i Dërguari صلى الله عليه وسلم pajtohet me atë gjykim dhe i dorëzohet!

E Profeti صلى الله عليه وسلم thotë:

"Kush bën një punë që nuk përkon me fenë tonë, ajo është e refuzuar!"¹

¹ Shënon Muslimi e të tjerë.

Thirrje:

Nëse tashmë e ke kuptuar domethënien e "Lã ilãhe il-IAll-llah, Muhamedu'r-resulu'll-llah" dhe faktin se kjo dëshmi është çelësi dhe themeli i Islamit, atëherë thuaj me zemër të singërtë: Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut; vepro sipas domethënies së kësaj dëshmie, që ta arrish lumturinë në të dy botët dhe të shpëtosh nga dënimi i amshueshëm!

Dije se koncepti i kësaj dëshmie kërkon që të jetësohen të gjitha shtyllat e Islamit. Ato janë detyrime të pashmangshme për muslimanin, e me to adhurohet Zoti i Madhërishëm! Lënia e paarsyeshme e ndonjëres prej këtyre shtyllave e cenon konceptin e fjalës "Lã ilãhe il-IAll-llah".

Shtylla e dytë e Islamit: namazi

Shtylla e dytë e Islamit është namazi, gjegjësisht pesë kohë të namazit përbrenda ditës dhe natës! Me këtë vepër besimtari lidhet me Zotin e tij: i flet e i lutet! Ky adhurim është barrikadë kundrejt mëkateve dhe punëve të ulëta! Nëpërmjet namazit fitohet një prehje e veçantë shpirtërore e trupore, si një portë drejt lumturisë së kësaj jete dhe të jetës së amshueshme!

Namazi i ka rregullat e veta, siç është pastërtia e trupit, e rrobave dhe e vendit. Muslimanit i kërkohet që, nëpërmjet përdorimit të ujit të pastër, të pastrohet nga të gjitha ndyrësitë, siç janë urina dhe të pëgërat (jashtëqitja). Me këtë disiplinë, besimtari e pastron trupin nga papastërtia konkrete dhe zemrën nga ajo abstrakte!

Namazi është kolona e fesë, gjegjësisht shtylla më e rëndësishme pas dy dëshmimeve - deklaratës islame. Muslimani e ka për obligim që, prej kur të hyjë në moshën e pjekurisë e derisa të vdesë, ta kryejë me përkushtim këtë adhurim. Po ashtu, ai e ka për detyrë që t'i urdhërojë familjen dhe fëmijët e tij që ta jetësojnë këtë ritual madhështor, saktësisht që nga mosha shtatëvjeçare, me synim që fëmijët të familjarizohen me namazin që nga ajo moshë. Allahu i Lartësuar thotë:

“...namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar.” (Kurani, 4:103)

Po ashtu, Allahu i Madhërishëm thotë:

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë.” (Kurani, 98:5)

Kuptimi i përgjithshëm i këtyre dy ajeteve:

Në ajetin e parë, Zoti i Lartë na tregon se namazi për besimtarët është një detyrë e pashmangshme, e të cilën doemos duhet që ta kryejnë në kohën e vet të caktuar! E në ajetin tjetër, Allahu Fuqiplotë na njofton se urdhri i Tij për krijesat dhe qëllimi i prurjes së tyre në ekzistencë është që ta adhurojnë dëlirësisht vetëm Atë, ta falin namazin dhe ta japin lëmoshën e detyrueshme (zekatin).

Në çfarëdo gjendje që të jetë muslimani e ka për detyrë kryerjen e namazit, madje edhe nëse është në gjendje të frikës apo të sëmundjes. E varësisht nga mundësitë, ai duhet të përpiqet ta kryejë këtë obligim, qoftë duke qenë në këmbë, i ulur apo edhe i shtrirë; në rast se nuk ka tjetër mundësi përpos se me shenja, ai mund dhe duhet të falet edhe ashtu. I Dërguari ﷺ na ka treguar se ai që nuk e falë namazin, nuk është musliman; citoj: "Besëlidhja në mes nesh dhe atyre është namazi; kushdo që e lë atë, veçse ka bërë kufër (mohim, dalje prej fesë)". Hadithi është sahih - autentik!

Pesë kohët e namazit janë: namazi i sabahut - agimit, namazi i drekës, namazi i ikindisë - pasdites, namazit i akshamit - mbrëmjes dhe namazi i jacisë - darkës.

Koha e namazit të sahabut - agimit, fillon me shfaqjen e dritës së agimit nga ana lindore dhe merr fund me lindjen e diellit. Nuk është e lejuar që ta vonosh kryerjen e namazit deri nga fundi i kësaj kohe! Pas ngjitjes së diellit në zenit - në pikën më të lartë qiellore, mbi kokën e vrojtuesit, fillon koha e namazit të drekës e vazhdon deri kur, përveç hijes së shmangies së diellit nga zeniti, gjatësia e hijes së trupave fizikë është e njëjtë me gjatësinë e vetë trupave! E me përfundimin e saj, fillon koha e namazit të ikindisë - të pasdites, e cila merr fund me zverdhimin e diellit. Nuk është e lejuar që të shtyhet kryerja e namazit deri nga fundi i kësaj kohe, por duhet të falet përgjatë periudhës kur dielli vazhdon të jetë i qartë, e i dukshëm! Koha e namazit të akshamit - mbrëmjes, fillon pas perëndimit të diellit dhe merr fund me largimin e skuqjes në horizont. Nuk është e lejuar ta vonosh deri nga fundi i kësaj kohe! Me përfundimin e kohës së akshamit, nis koha e namazit të jasisë - darkës, e cila merr fund me përfundimin e natës!

Nëse muslimani nuk e përfill këtë rregullore kohore gjatë kryerjes së namazit, pa ndonjë arsye të pranueshme fetare, mëkaton shumë keq; ai duhet të pendohet tek Allahu, të përdhet e të mos e përsërisë këtë gabim trashanik!

Allahu Fuqiplotë thotë:

“Mjerë për ata, të cilët kur falen janë të pakujdesshëm për namazet.” (Kurani, 107:4-5)

Dispozitat e namazit

Së pari: Pastërtia

Para hyrjes në ritualin e namazit, muslimani doemos duhet të pastrohet. Fillimisht i pastron pjesët intime të trupit - nëse ka kryer nevoja fiziologjike, e pastaj pastrohet me anë të ritit të quajtur abdes - vuđu!

E abdesi - vuđui, kryhet në këtë mënyrë: e vendos me zemër, e jo duke e shqiptuar, se po e kryen ritin e pastrimit - abdesin, sepse Zoti e di qëllimin e tij edhe pa e shqiptuar ai, si dhe një gjë e tillë (shqiptimi) nuk ishte traditë profetike, pastaj thua: "Bismil-lāh" (Me emrin e Allahut); pastaj shpëlan gojën dhe e pastron hundën; e lan fytyrën, pastaj krahët, duke i përfshirë edhe bërrylat dhe duke i dhënë përparësi anës së djathtë; fërkon kokën me duar të lagura, e pastaj veshët dhe në fund i lan këmbët, duke i përfshirë edhe nyjat e këmbëve e duke i dhënë përparësi anës së djathtë!

Me kryerjen e nevojave fiziologjike, lëshimin e gazrave, gjumit apo humbjes së vetëdijes, ky rit pastrimi e humb vlefshmërinë e vet, ndaj ai duhet të përsëritet kur duam që ta falim namazin! Po ashtu, ekziston edhe një rit tjetër pastrimi; ai është gusli - pastrimi i madh, gjegjësisht larja e tërë trupit! Ky rit është i detyrueshëm kur muslimani apo muslimania ejakulon, qoftë si pasojë e epshit apo e ëndrrave në gjumë; po ashtu, kur muslimania e përfundon ciklin menstrual dhe periudhën e lehonisë, ajo duhet ta pastrojë e ta lajë trupin në tërësi! Muslimania gjatë kohës

së menstruacioneve dhe të lehonisë, nuk guxon të falet dhe nëse falet në atë gjendje ai namaz është i pavlefshëm. Asaj nuk i kërkohet as namazi e as kompensimi i tij; ky është lehtësim i Zotit për të! Kurse obligimet tjera duhet t'i kompensojë pas pastrimit të saj, njëjtë sikurse mashkulli.

Në mungesë të ujit apo të mundësisë për ta përdorur atë - për shkak të ndonjë problemi shëndetësor ose për ndonjë arsye tjetër, ekziston rituali alternativ, i quajtur "tejemmum". Ai bëhet në këtë mënyrë: e vendos me zemër se po e kryen ritin e pastrimit - tejemmumin, thua: "Bismillah"; me të dy duart i mëshon tokës - një herë, e me to pastaj e fërkon fytyrën; tutje, me pëllëmbën e dorës së majtë e fërkon pjesën e sipërme të dorës së djathtë dhe anasjelltas. Kështu përfundon tejemmumi! Ky rit vlen për të gjithë ata që, o nuk kanë ujë, o druhen ta përdorin atë, qoftë një njeri i pastër që dëshiron abdes, një i papastër që dëshiron gusël apo një femër që ka përfunduar ciklin menstrual apo periudhën e lehonisë dhe vendos të pastrohet!

Së dyti: Forma e namazet

Namazi i sabahut - agimit

Bëhet fjalë për dy rekate. Muslimani, qoftë mashkull a femër, drejtohet nga kibla - Qabja, Mesxhidi i Shenjtë në Mekë, e vendos me zemër, pa e shqiptuar fare, se po fal namazin e sabahut - agimit dhe thotë: "All-llahu ekber!" (Allahu është më i Madhi).

Pastaj fillon ta lexojë lutjen e çeljes së namazit, e cila është: "Subhâneke, All-llahumme we bihamdike, we tebâreke'smuke, we te'âlâ xhedduke, we lâ ilâhe ġajruke!" Pastaj thotë: "E'ûdhu bil-lâhi mine'sh-shejtâni'rr-rraxhîm", pastaj e këndon kaptinën "El-Fatiha", e ajo është:

El-ĥamdu lil-lahi rabi'l-'alemîn. [Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve]

Err-rraĥmani'rr-rraĥîm. [të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit]

Mâliki jewmi'd-dîn. [Sunduesit të Ditës së Gjykimit.]

Ijġâke ne'abudu we ijġâke neste'în. [Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë]

Ihdina'ş-şirata'l-mustekîm. [Udhëzona në rrugën e drejtë!]

şirata'l-ledhine en'amte alejhim ġajri'l-maġdûbi 'alejhim we'le'ġ-ġâl-lîn. [Udhëzona në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!]

Gjatë namazit, këndimi i Kuranit duhet të bëhet në gjuhën arabe¹; pastaj thua: "All-llahu ekber" (Allahu është më i Madhi!), përkulësh në ruku - duke vendosur pëllëmbët e duarve mbi gjunjë dhe thua: "Subhane rabije'l-adhīm" (I patëmeta është Zoti im i Madhërishëm!)

Pastaj ngrihet duke thënë: "Semi'all-llahu limen hamideh" (O Allah, dëgjoje lavdin që po të bëhet! Ose: Allahu i është përgjigjur atij që e ka lavdëruar Atë); e kur të drejtohet, duke qenë në këmbë thotë: "Rabbena we leke'l-hamd" (Qofsh lavdëruar Zoti ynë!); pastaj thotë: "All-llahu ekber" (Allahu është më i Madhi!) dhe shkon përdhe duke vendosur ballin, hundën, gishtat e këmbëve, gjunjët dhe shuplakat e duarve në tokë, e në këtë gjendje - që quhet sexhde, thotë: "Subhane rabije'l-e'ala" (I patëmeta është Zoti im, i Lartësuar!), pastaj ngrihet ulur duke thënë: "All-llahu ekber" (Allahu është më i Madhi!), pastaj duke qenë ulur thotë: "Rabbi'gfir lī" (Falmë, o Zoti im!), pastaj thotë: "All-llahu ekber" (Allahu është më i Madhi!) dhe bën sërish sexhde, sikurse herën e parë dhe thotë: "Subhane rabije'l-e'ala" (I patëmeta është Zoti im, i Lartësuar!), pastaj ngrihet në këmbë e thotë: "All-llahu ekber" (Allahu është më i Madhi!) dhe fillon këndimin e kaptinës El-Fatiha, e cila

¹ Sepse leximi i tij në një gjuhë tjetër nuk mund të konsiderohet "Kuran", ngase shprehjet dhe frazat e Kuranit është e pamundur që të përkthehen, ndryshe nga kuptimet e tij, ato mund të përçohen në një gjuhë tjetër. Në çdo përkthim shohim se mungon origjinaliteti i Kuranit të shpallur në gjuhën arabe, i cili është përplot mrekulli e madhështi shprehëse!

është: El-ḥamdu lil-lahi rabī'l-'alemīn. [Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve] deri në fund, siç qe në rekatin e parë; pastaj thotë: "All-llahu ekber" (Allahu është më i Madhi!), përkulet në ruku, pastaj ngrihet sërish dhe lëshohet përdhe për të bërë dy sexhde - përherë duke thënë të njëjtat lutje si ato të rekatit të parë!

Pastaj ulet dhe thotë:

"Et-tehij-jātu lil-lahi we's-ṣalawātu we taj-jibātu, e's-selāmu 'alejke ejuhe'n-nebij-ju we rahmetu'll-llāhi we berekātuhu; es-selāmu 'alejnā we 'ala ibādi'l-lahi's-ṣalihīn; eshhedu en lā ilāhe il-lall-llah, we eshhedu enne muhammeden abduhu we resuluh; All-llahumme ṣal-li we sel-lim 'ala Muhammed, we 'ala āli Muhammed, kemā ṣal-lejte 'ala Ibrahim, we 'ala āli Ibrahim, inneke hamīdun mexhīd". (Madhërimi, adhurimi dhe lavdia qofshin për Allahun! Shpëtimi, mëshira dhe begatia e Allahut, qofshin me ty o Profet! Shpëtimi e pagja qofshin me ne dhe me robërit e mirë të Allahut! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij! O Allah, lavdëro dhe mëshiro Muhamedin dhe familjen e Tij, ashtu siç e lavdërove dhe mëshirove Ibrahimin dhe familjen e tij; Vërtet, Ti je i Lavdishëm e Bamirës i Madh!)

E kthen kokën në anën e djathtë dhe thotë:

"Es-Selāmu 'alejkum we rahmetu'll-llāh"

Pastaj kthen kokën në anën e majtë dhe thotë:

"Es-Selāmu 'alejkum we rahmetu'll-llāh"

E me këtë përfundon namazi i sabahut!

Namazi i drekës, i ikindisë dhe i jacisë falen me nga katër rekate. Dy rekatet e para kryhen në të njëjtën mënyrë si ato të sabahut - të agimit, përveçse kur të jetë në uljen e teshehudit - në fund të dy rekateve të para, nuk e përfundon namazin me selam, mirëpo ngrihet sërish që t'i falë edhe dy rekate të tjera sikur ato të parat. Kur të arrijë në uljen e fundit, i thotë të njëjtat lutje si ato të teshehudit të parë, përpos që i shton edhe disa lutje që Zoti ta bekojë, mëshirojë dhe ta lavdërojë Profetin ﷺ e pastaj e përfundon namazin në të njëjtën mënyrë sikur në kohën e sabahut - agimit, duke thënë në anën e djathtë, e pastaj në të majtë: "Es-selāmu 'alejkum we rahmetu'll-Ilāh".

Namazi i akshamit - i perëndimit, përbëhet nga tre rekate. Dy të parat falen ashtu siç u shpjegua më herët, mirëpo pas uljes në teshehudin e parë, namazfalësi nuk e përfundon namazin, mirëpo çohet edhe një herë, që të falë edhe një rekat tjetër, forma e të cilit është e njëjtë me rekatet e mëparshme. Namazi përfundon në uljen e dytë të teshehudit, duke dhënë selam! E nëse namazfalësi e përsërit atë që e thotë në ruku e në sexhde, kjo është më mirë.

Burrat e kanë për obligim që këtë vepër (faljen e pesë namazeve ditore) ta kryejnë bashkërisht në faltore - në xhami, në mesxhid! Njëri nga ta - imami, që dallohet me mirëlexim të Kuranit, njohje të vetë ritit dhe fetari shembullore, u prin të tjerëve. Ai këndon me zë - që dëgjohet nga të tjerët, në namazin e sabahut, në dy rekatet

e para të akshamit dhe në dy rekatet e para të jacisë! Kurse ata që falen pas tij e dëgjojnë leximin e tij.

Namazi më i mirë i gruas është namazi i falur në shtëpi. Ajo duhet që, përgjatë faljes së namazit, të jetë e mbuluar në tërësi, në përjashtim të fytyrës - të cilën gjatë faljes së namazit e shpalos, kurse në prezencë të burrave të huaj, e mbulon. Nuk ka ndonjë ndalesë që ajo të falet në xhami, mirëpo duhet t'i përmbahet normës dhe etikës së daljes nga shtëpia: të jetë e mbuluar dhe të mos parfumohet; e kur të hyjë në faltore, të falet prapa radhëve të burrave, që të mos ketë joshje e provokim ndërmjet tyre!

Namazi duhet të falet me plotë frikë-respekt e përlësi për Zotin! Lypset që ky adhurim të përjetohet thellësisht dhe të kryhet me një qetësi të veçantë psiko-fizike - pa ngutim, pa lëvizje të kota dhe shikim drejt qiellit! Nuk lejohet të thuhet fjalë jashtë ajeteve kuranore dhe lutjeve specifike të namazit, (vetëm nëse namazliu dëshiron t'ia tërheqë vërejtjen imamit të tij për ndonjë gabim në namaz ose dëshiron t'i përgjigjet dikujt që e thërret nga jashtë, atëherë thotë Subhanall-llah. Kurse femra, qëllimet e tilla i arrin duke rrahur me shuplakën e dorës së djathtë atë të majtën dhe nuk lëshon zë), ngase thelbi dhe qëllimi i namazit është përmendja e Allahut të Madhërishëm!

Në ditën e premte, falet namazi i xhumasë, një namaz dyrekatësh dhe i përjavshëm që zë vendin e kohës së namazit të drekës në atë ditë. Detyrimsht duhet të falet me imam, i cili para se t'u prijë besimtarëve në namaz - ku

këndon me zë, i mban dy fjalime këshilluese e ndërgjegjësuere (hutbeja).

Shtylla e tretë e Islamit: zekati - lëmosha e detyrueshme

Zoti i ka obliguar besimtarët që, kur pasuria e tyre të arrijë një sasi të caktuar - e quajtur nisab, të japin nga ajo pasuri, çdo vit, një përqindje të caktuar për të varfrit dhe të tjerët që, sipas Kuranit Famëlartë, e meritojnë lëmoshën - zekatin!

Për arin dhe argjendin duhet të jepet zekat; nisabi i floririt është 85 gramë (20 mithkalë), kurse ai i argjendit 595 gramë (200 dirhemë)! Duke u bazuar te vlera e arit dhe e argjendit, jepet edhe zekati i të hollave - monedhave valutë! Po ashtu, edhe për mallrat tregtare duhet të jepet zekat, nëse ato rrinë një vit pa u shitur dhe e arrijnë nisabin përkatës! Nisabi i kokrave - drithërave, dhe i fryteve është treqind saë - e, sasia e një saë-je është katër grushte (të bëra bashkë). Nëse patundshmëritë bëhen gati për shitje, atëherë duhet të jepet zekat për vlerën që kanë, e nëse janë për qiradhënie, atëherë jepet zekat vetëm për vlerën e qirasë. Përqindja që duhet dhënë - çdo vit, sa i përket arit, argjendit dhe mallrave tregtare është çereku i një të dhjetës, gjegjësisht 2.5%. Kurse për drithërat dhe frytet, duhet të jepet zekat, o dhjetë për qind - nëse janë ujitur pa mund njerëzor, si p.sh. me shi e ujë lumenjsh, o pesë për qind - nëse janë vaditur me mund njerëzor.

Për çdo korrje e vjelje të drithërave, e të fryteve, duhet të jepet lëmosha e detyrueshme.

E sa i përket deveve, lopëve dhe deleve, rregullorja e zekatit të tyre mund të lexohet në librat e jurisprudencës islame.

Allahu i Madhërishëm thotë:

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë.” (Kurani, 98:5)

Zekati u ofron skamnorëve një mirëqenie shpirtërore dhe materiale, kurse klasave të shoqërisë një mundësi që të afrohen ndërmjet vete!

Kjo fe, përveç zekatit, ngërthen në vete një tërësi përbërësish të tjerë që veprojnë në interes të çështjeve sociale e financiare të shoqërisë. Në Islam është e detyrueshme që, nëse një vend kaplohet nga uria dhe thatësia, të pasurit t'u dalin në ndihmë të varfërve; nuk është e lejuar që ti të ngopesh, ndërsa fqinji yt të mbetet i uritur; muslimani është i obliguar që, në ditën e festës së Bajramit, për çdo anëtar të familjes, madje edhe për fëmijën dhe shërbëtorin, t'u japë të varfërve lëmoshë (zekātu'l-fitër) - sasia e të cilit është katër grushte (të bëra bashkë) nga ushqimi bazë i atij vendi. Muslimani e ka obligim që t'i realizojë zotimet për vepra të lejuara fetarisht. Në të kundërtën e ka obligim t'i shpaguajë betimet dhe

zotimet e papërmbushura¹. Zoti e ka nxitur muslimanin që të japë lëmoshë vullnetare, si dhe i ka premtuar shpërblim të veçantë e të shumëfishuar!

Shtylla e katërt e Islamit: agjërimi

Bëhet fjalë për agjërimin e muajit ramazan, gjegjësisht agjërimin e muajit të nëntë hënor.

Forma e agjërit

Para se të gdhijë agimi, agjëruesi e ndan mendjen që ta agjërojë atë ditë (e bën nijet). Sakaq, ndalet nga haja, pija dhe marrëdhëniet intime derisa të perëndojë dielli në fund të ditës. Ai e agjëron tërë muajin e ramazanit - adhurim për Zotin dhe përpjekje për të fituar pajtimin e kënaqësinë e Tij!

Të mirat e agjërit janë të shumta e të panumërta. Dobia kryesore është:

fakti se bëhet fjalë për vepër adhurimi e bindje ndaj Zotit. Robi e braktis epshin, ushqimin dhe pijen, vetëm e vetëm për hir të Zotit, ndaj agjërimi është një mundësi ideale e fisnikërimit të shpirtit dhe e forcimit të lidhjes me Allahun.

¹ Është i lirë ta përzgjedhë njërën nga këto forma të shpagimit: të lirojë një skllav ose të ushqejë ose të veshmbathë dhjetë skamnorë; Nëse nuk ka mundësi ta bëjë asnjërën, atëherë duhet t'i agjërojë tri ditë

Ndërsa sa i përket dobive shëndetësore, ekonomike e shoqërore, ato nuk mund të numërohen dot. Vërtet, vetëm një njeri që agjëron me besim të fortë, i përjeton ato!

Allahu i Lartëmadhërishëm thotë:

“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.”; deri te fjala e të Madhërishmit: “Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër (le të agjërojë më vonë) aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t’jua lehtësojë dhe jo që t’jua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjëritit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjëritit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë.” (Kurani, 2:183, 185)

Prej dispozitave të agjëritit - të dala nga Kurani dhe tradita profetike:

I sëmuri dhe udhëtari kanë të drejtë që të mos agjërojnë, mirëpo janë të obliguar që ato ditë t’i kompensojnë më vonë!

Gruaja gjatë ciklit menstrual dhe periudhës së lehonisë nuk e ka të lejuar që të agjërojë. E nëse agjëron, ai agjërim është i pavlefshëm. Ajo duhet që ato ditë të paagjëruara t’i kompensojë më vonë, kur të jetë pastruar.

Shtatzëna dhe mëkuesja - gjidhënësja, nëse kanë drojë për vetveten apo fëmijët e tyre se mund të dëmtohen nga agjërimi, kanë të drejtë që të mos agjërojnë, mirëpo duhet që ato ditë t'i kompensojnë më vonë.

Nëse agjëruesi, për shkak të harresës e habisë, ha ose pi diçka, agjërimi i tij nuk zhvleftësohet (edhe pse ai duhet të nxjerrë nga goja ushqimin që mund ta ketë në gojë pasi t'i kujtohet se është agjërueshëm), ngase harresa, gabimi dhe imponimi janë gjëra të falshme për umetin e Muhamedit

• صلى الله عليه وسلم

Shtylla e pestë e Islamit: haxhi – pelegrinazhi

Duhet që një herë brenda jetës të bëhet pelegrinazh në Shtëpinë e Shenjtë - Qabe. Kjo vepër mund të përsëritet në mënyrë vullnetare. Haxhi ka shumë dobi:

E para: Është një vepër ku shpirti, trupi dhe pasuria bëhen bashkë për ta adhuruar Zotin!

E dyta: Aty, në një vend, në një kohë e me një lloj veshjeje, mbarë muslimanët bëhen bashkë që ta adhurojnë të vetmin Zot. Çdo lloj dallimi ndërmjet tyre bie poshtë: pari e popull; pasanik e fukara; të bardhë e të zinj; të gjithë paraqiten si krijesa dhe robër të Allahut. Aty muslimanët njihen ndërmjet vete dhe krijojnë ura bashkëpunimi. Pamjet me plot turma ua sjellin ndërmend atyre ringjalljen dhe tubimin e llogaridhënies, ndaj edhe motivohen që të bëhen gati e të bëjnë vepra të mira.

Urtësia dhe qëllimi i rrotullimit përreth Qabes - në drejtim të së cilës falen muslimanët, dhe i qëndrimit në Arafat, Muzdelife, Mina e gjetiu në Mekë, është që t'i bëhet adhurim Zotit të Madhërishëm - në vende të shenjta, ashtu siç ka urdhëruar Ai.

Assesi Qabja, vendet e shenjta dhe krijesat në tërësi, nuk adhurohen. As dëm e as dobi nuk pritët prej tyre! Në të vërtetë, adhurimi i takon vetëm Allahut - vetëm nga Ai vjen dobia dhe dëmi! Sikur urdhri i Zotit të mos ishte që pelegrinazhi të bëhet në Qabe, atëherë shkuarjet atje nuk do të ishin të vlefshme. Kjo ngase adhurimi nuk bazohet në

logjikë e në teka, po në urdhëresat e Zotit, qofshin të përmendura në Kuran apo në traditën profetike.

Allahu i Madhërishëm thotë:

“...dhe vizita (për haxh) e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd.”¹
(Kurani, 3:97)

Sa i përket Umres - vizitës së Qabes, përveç pelegrinazhit të përvitshëm, ajo është detyrim një herë në jetë. Mund të bëhet bashkë me haxhin ose veçmas. Kurse vizitimi i xhamisë së Profetit ﷺ në Medinë, nuk është obligim, as në kohën e haxhit e as në një kohë tjetër, mirëpo është një vepër e pëlqyer dhe e shpërblyer, moskryerja e së cilës nuk sjell ndëshkim!

E sa i përket hadithit:

"Ai që e bën haxhin e nuk më viziton mua, më ka tëhuajtur!"

Ky hadith nuk mban - është transmetim i trilluar.²

¹ E sa i përket pelegrinazhit që bëhet nga ana e injorantëve nëpër varreza dhe tyrbe, diçka e tillë është devijim i qartë dhe kundërshtim i urdhrit të Zotit të Lartëmadhërishëm dhe të Profetit ﷺ. Kuntari i Zotit ﷺ thotë: "Nuk merret rrugë për ndonjë vend (me qëllim adhurimi), përveçse nëse mësyhen tri xhamitë: Xhamia e Shenjtë - Qabja, mesxhidi im dhe Mesxhidu'l-Aksaja!"

² Sikurse edhe hadithi: "Kërkoni ndërmjetësim me pozitën time, ngase ajo ka shumë vlerë tek Allahu"; dhe hadithi: "Kush ka mendim

Nëse ia mësyn Medinës për vizitë, atëherë ajo duhet të bëhet për xhaminë e Profetit ﷺ ku pasi të arrish i fal dy rekate si përshëndetje për xhaminë, pastaj e përshëndet Profetin ﷺ me edukatë, pa ngritje të zërit dhe pa iu drejtuar me ndonjë lutje; duke iu drejtuar me fjalët: "Es-selamu alejke ja Resulall-llah", e më pas largohesh nga aty. Këto ishin porositë e tij dhe të sahabëve të nderuar.

E ata që qëndrojnë përpara varrit të Profetit ﷺ të përlulur siç qëndrojnë në namaz, i luten atij për nevojat që kanë dhe e marrin për ndërmjetësues tek Allahu, të gjithë ata janë idhujtarë, ndërsa Profeti ﷺ është larg prej tyre. Ndaj, mos të gaboje dikush prej muslimanëve që të veprojnë diçka të tillë me Profetin ﷺ apo me dikë tjetër. Pastaj, i viziton varret e dy shokëve të tij, Ebu Bekrit dhe Umerit, -paçin pajtimin e Allahut!-, për të vazhduar tutje me vizitën e varrezave në "El-Bekīe" dhe ato të dëshmorëve. Vizita e varrezave sipas normave islame është siç vijon: i përshëndet me selam, i lutesh Zotit për ta, e kujton vdekjen dhe largohesh.

Shpjegimi i haxhit dhe i umres: Pelegrini përgatitet materialisht me pasuri të pastër - hallall, dhe i shmanget pasurive dhe fitimeve të ndaluara - haram, ngase për pasojë të tyre, mund të mos i pranohen pelegrinazhi dhe lutjet.

të mirë për ndonjë gurë, ai mund t'i ndihmojë atij", e të tjera hadithe të shpifura që nuk gjenden në librat e njohur të hadithit, por në libra të disa besëtytnorëve devijues.

Na është transmetuar në hadithin e Profetit ﷺ se ai ka thënë:

"Çdo mish që nëpërmjet hajes së ndaluar është zhvilluar është prioritet dhe meritë e zjarrit (të xhehenemit)!"

Gjen shoqëri të mirë për udhë - njerëz të monoteizmit dhe të besimit të drejtë!

El-mevākīt - pikënisjet gjeografike të pelegrinazhit:

Kur të arrijë pelegrini te mīḳāti, aty e shpreh hyrjen në ihrām - bërja nijet dhe nisja e ritualeve të pelegrinazhit. Kjo mund të behët edhe duke qenë në veturë; e nëse jemi në aeroplan, atëherë duhet të kihet edhe më shumë kujdes që, pa e tejkaluar atë pozitë gjeografike, ta kryejmë këtë rit të rëndësishëm! Ekzistojnë pesë mikate gjithsej:

Mīḳāti Dhu'l-Hulejfa (Ebjāru 'Ali - pusët e Aliut) - mīḳāt i veçantë për banorët e Medinës.

El-Xhuhfe (në afërsi të Rabigut) - mīḳāti i banorëve të Shamit - Levantit, Egjiptit dhe i Magrebit - Afrikës Veriore.

Ḳarnu'l-menāzil - (Es-Sejl - Wadi muhrim) - mīḳāti i banorëve të Nexhdit - pjesës qendrore të Gadishullit Arabik, Taifit dhe të asaj ane në përgjithësi.

Dhatu Irḳ - mīḳāti i banorëve të Irakut.

Jelemlem - mīḳāti i banorëve të Jemenit.

Këto mīkâte janë të vlefshme për gjithsecilin që kalon atypari, edhe nëse nuk është i anës përkatëse! Ndërsa banorët e Mekës dhe të tjerët përreth tyre që nuk i përfshin ndonjë mīkāt, ata hyjnë në ihrām nga vendbanimet e tyre.

Si hyhet në ihrām?

Është e pëlqyeshme që pelegrini të lahet, të pastrohet, e të parfumohet; pastaj, në mīkātin përkatës t'i veshë pëlhurat e quajtura "ihrām". Pelegrini që udhëton në vijë ajrore, bëhet gati që në vendin e tij, e kur të afrohet apo të kalojë mbi mīkātin e anës së tij, e bën nijetin dhe e shqipton hyrjen në ihrām! Pra, veshja e pelegrinit - mashkull është: dy pëlhura - pa ndonjë qepje penj (pra pa qenë e qepur në formë të trupit apo ndonjë gjymtyre të tij), njëra për të mbuluar pjesën e sipërme, kurse tjetra pjesën e poshtme, përherë duke lënë kokën të zbuluar!

Ndërsa sa i përket veshjes së femrës, nuk ka diçka të veçantë, përpos që nuk lejohet mbulimi i fytyrës dhe i duarve me diçka të qepur me penj, si burka dhe dorëzat; Ajo, në prezencë të burrave të huaj, e mbulon fytyrën e saj me shami apo vello, ashtu siç vepronin nënat e besimtarëve dhe sahabeshat.

Pas veshjes së ihrāmit, e vendos me zemër hyrjen në ritualet e umres dhe thotë: "All-llahumme lebbejke 'umreten!" (O Allah, të përgjigjem me Umre!) Kjo formë e pelegrinazhit - e quajtur "temetu", ku bëhen bashkë umreja dhe haxhi është më me vlerë, ngase kjo ishte urdhëresa e

Profetit ﷺ për shokët e tij. Ndërsa ai që e merr me vete kafshën që mëton ta dhurojë, e ta sakrifikojë në Mekë, ai e bën pelegrinazhin e quajtur "ķiran" - siç veproi Profeti ﷺ, ndërsa hyrjen në ihrām e shpreh me fjalët: "Allahumme lebbejke umreten we haxhen! (O Allah, të përgjigjem me Umre dhe Haxh!) Ai nuk lirohet nga ihrāmi deri në ditën e festës së Bajramit - derisa të therret kafsha e tij! Ndërsa lloji i tretë i pelegrinazhit është "ifrādi", ku pelegrini e bën njet vetëm Haxhin, e në ihrāmin e të cilit hyhet duke thënë: "Allahumme lebbejke haxhen!" (O Allah, të përgjigjem me haxh!)

Ndalesat e pelegrinit:

Me fillimin e pelegrinazhit, ndalohen:

1. Marrëdhëniet intime dhe pararendëset e saj, si puthja, prekja dhe të folurit me epsh, fejesa, e kurorëzimi - pra, pelegrini as nuk martohet, e as nuk e marton askënd!
2. Rruajtja ose heqja e qimeve.
3. Prerja e thonjve.
4. Mbulimi i kokës - ndalesë për burrat. Ndërsa, t'i ikësh diellit nëpërmjet shfrytëzimit të ombrellës, tendës ose automobil, nuk ka ndonjë ndalesë.
5. Parfumimi dhe nuhatja e parfumeve!
6. Gjuetia - as nuk gjuan, e as nuk e udhëzon dikë nga gjahu!

7. Të gjitha veshjet e qepura me penj në formë të trupit apo të ndonjë gjymtyrë të tij - sa i përket burrave, ndërsa për femrat vetëm ato që janë për mbulimin e fytyrës dhe të duarve! Burri mbath sandale (nallane), e nëse nuk ka, atëherë meste. Nëse e vepron ndonjë nga këto ndalesa nga padija a harresa, e ndërpret atë vepër dhe nuk detyrohet të bëjë ndonjë shpagim.

Kur pelegrini të arrijë në Qabe, rrotullohet rreth saj shtatë herë, duke e filluar tavāfin - rrethrotullimin, nga Guri i Zi! Ky tavaf i përket Umres dhe quhet "tavāfu'l-kudūm"! Gjatë tavāfit nuk kemi lutje të veçanta, mirëpo përgjithësisht përmendet dhe lutet Zoti.¹

Pastaj i fal dy rekate të tavāfit; nëse ka mundësi, i fal prapa mekāmī, e nëse jo, atëherë kudo qoftë në hapësirat e Xhamisë së Shenjtë. Pastaj shkon në mes'ā - shtegu i ecjes qarkore "El-Safā-El-Merwā". Fillon nga kodra e El-Safāsë, hip mbi të, drejtohet nga kibla, e madhëron Zotin dhe e lut Atë, pastaj ecën në drejtim të kodrës El-Merwā, hip mbi të, drejtohet nga kibla, e madhëron Zotin dhe e lut Atë, e pastaj kthehet sërish tek El-Safāja, duke vepruar kështu derisa t'i bëjë shtatë qarqe; çdo vajtje nga kodra në kodër llogaritet qark. Pastaj qethet. E sa i përket grave, mjafton t'i presin flokët vetëm sa majat e gishtave! Këtu përfundon umreja e hāxhiut që kryen Haxhin Temetu, i cili tani më lirohet nga

¹ Përveç kur të jetë në mes të dy këndeve, thotë: "Rabbena atina fid-dunja haseneten we fil-ahireti haseneten we kina adhaben-nar", që do të thotë: "O Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe në të mëtejmen, si dhe ruana nga dënimi i zjarrit!

ihrāmi, gjegjësisht i lejohen ato gjëra, të cilat përgjatë ihrāmit, i kishte të ndaluara!

Nëse gruas pelegrine i fillon cikli menstrual ose periudha e lehonisë, para ose pas hyrjes në ihrām, ajo e shndërron pelegrinazhin e saj nga ai i llojit "temetu" në llojin "ķiran" - me shpresë që, nëse pastrohet para fillimit të ditëve të pelegrinazhit, gjegjësisht para ditës së tetë të muajit Dhu'l-hixhe, të rikthehet te lloji "temetu", pra pastrohet, e kryen umren dhe i bashkëngjitet haxhilerëve tjerë. Ajo gjatë periudhës së menstruacioneve apo lehonisë ka të drejtë që t'i kryejë të gjitha ritualet e hāxhit, që nga ihrāmi e tutje, me përjashtim të tavāfit, i cili duhet bërë pas pastrimit!

Tavāfi, gjegjësisht ai i quajtur "ifāde", dhe s'aji, të bëra pas pastrimit janë të mjaftueshme për hāxhin dhe 'umren e gruas pelegrine. Kështu i kishte thënë Profeti ﷺ 'Aishes, -radijallahu anha!-, ngase pelegrinazhi i llojit "ķirān" është njësoj si ai i llojit "ifrād", gjegjësisht kanë vetëm një tavāf¹ dhe një s'aj, gjë e thënë dhe e bërë nga vetë Profeti ﷺ e frazuar në hadithin profetik: "Deri në ditën e kiametit, 'Umreja ka hyrë në tërësinë e haxhit!"

¹ Ky tavāf bëhet në ditën e festës ose më vonë. Sa i përket tavāfit të bërë para nisjes së ritualeve të haxhit, i quajtur "tavāfu'l-kudūm", ai është tavāf vullnetar. S'aji, sa i përket atyre që bëjnë haxhin e llojeve: "ķirān" dhe "ifrād", u kërkohet vetëm një herë, ndaj nëse e bëjnë atë bashkë me tavāfin "ķudūm", ai u mjafton, kështu që nuk u kërkohet që ta bëjnë sërish pas tavāfit "ifāde".

Pelegrinët që ndodhen në Mekë, në ditën e tetë të muajit hënor Dhu'l-hixhe, prej banesave të tyre hyjnë në ihrām - sikur në herën e parë në mīkāt. Pasi ta ndajnë mendjen, gjegjësisht ta bëjnë nijetin për haxh, dhe të thonë: "All-llahumme lebbejke haxhen" (O Allah, të përgjigjem me haxh!), ata hyjnë në ritualet e haxhit, e që aty e tutje i shmangen ndalesave të pelegrinazhit, deri në ditën kur të kthehen nga Muzdelifja për në Minā - në ditën e therjes së kurbaneve, e t'i gjuajnë guralecët në "Xhemretu'l-'akabe", e më pastaj, burrat të qethen e gratë t'i shkurtajnë flokët.

Pasi haxhiu të hyjë në ritualet e haxhit, gjegjësisht në ditën e tetë, niset për në Minā; aty namazet i fal të shkurtuara - pa i bërë bashkë, si dhe bun. Të nesërmen, në ditën e nëntë, gjegjësisht në mëngjesin e ditës së 'Arafatit, niset për në (faltoren) "Nemira", ku rri dhe i fal me xhemat, (e nëse nuk gjendet në atë faltore i fal në vendndodhjen e tij) të bashkuara dhe të shkurtuara namazin e drekës dhe atë të ikindisë. Pas mesditës niset për në 'Arafāt, ku ka të drejtë të shkojë që në mëngjes - pa u ndalur fare te faltorja "Nemira". Arafati në tërësi është "meuķif" - vendqëndrim pelegrinazhor.

Haxhiu gjatë qëndrimit në 'Arafāt i përkushtohet dhikrit, lutjes dhe kërkimfaljes. Përherë drejtohet nga kibla dhe jo nga kodra - "Xhebelu'r-rahme", e cila është thjesht një pjesë e tërësisë së 'Arafatit. Të ngjitesh në atë kodër me qëllim adhurimi apo të fërkohesh me gurët e tij është diçka e palejueshme, ngase bëhet fjalë për veprime të shpikura.

Haxhiu nuk largohet nga 'Arãfati pa perënduar dielli. Me rënien e muzgut, haxhilerët nisen për në Muzdelife, ku pasi të arrijnë, i falin të bashkuara - në kohën e jacisë, namazin e akshamit dhe të jacisë - e këtë të fundit duke e shkurtuar. Aty bujnë, e kur të gdhijë agimi, e falin namazin e sabahut dhe e përmendin Allahun. Pa lindur dielli i asaj dite, haxhilerët nisen për në Minã, ku pasi të mbërrijnë, saktësisht pas lindjes së diellit, e gjuajnë "Xhemretu'l-'akabanë" me shtatë guralecë - të vegjël sikur qiqrat. Gjuajtja me sandale është e palejueshme dhe tallje, të cilën ua zbukuron djalli; në të vërtetë, djalli mposhtet atëherë kur ne i ndjekim udhëzimet e Profetit ﷺ dhe i shmangemi ndalesave të tij!

Pas gjuajtjes së guralecëve, pelegrini e ther kafshën - hedjin (që i dedikohet vendit të shenjtë si përpjekje për t'iu afruar Allahut), pastaj i qeth ose i rruan flokët - e kjo e fundit është trefish më me vlerë, ndërsa gratë munden vetëm t'i shkurtojnë ato. Pastaj vishet me rrobat e zakonshme dhe tani e tutje i lejohet gjithçka prej ndalesave të pelegrinazhit, përveç marrëdhënieve intime dhe pararendëseve të tyre. Pastaj shkon në Mekë për të bërë tavãfin e haxhit dhe s'ajin, e pastaj ndalesat e pelegrinazhit shfuqizohen në tërësi për të, madje edhe marrëdhëniet intime. Më pastaj ai kthehet në Minã për të kryer obligimin e bujtjes, gjegjësisht të qëndrimit aty në ditët e festës dhe në dy ditët vijuese. Në ditën e njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë të Dhu'l-hixhes, pas ngritjes së diellit në zenit, i gjuan me nga shtatë guralecë të tre pikat e gjuajtjes, duke filluar me pikëgjuajtjen e vogël, e cila është më e afërta nga Meka,

pastaj atë të mesme dhe në fund atë të madhe, gjegjësisht "Xhemretu'l-'akabe", në drejtim të së cilës ka gjuajtur për herë të parë në ditën e festës. Secilën e gjuan me nga shtatë guralecë, e në çdo gjuajtje e madhëron Zotin duke thënë: "All-llahu ekber!" (Allahu është më i Madhi!). Guralecët i merr atypari te tenda ku rri në Minã. Nëse nuk gjen vend e bujtinë në Minã, atëherë zë vend diku nga fundi i zonës së tendave afër Mināsë!

Haxhiu është i lirë që, në ditën e dymbëdhjetë, pas gjuajtjes së guralecëve, të largohet nga Minã, mirëpo nëse qëndron deri në ditën e trembëdhjetë, kjo është më me vlerë, e më pastaj, pas ngritjes së diellit në zenit, t'i gjuajë guralecët. Nëse e ka ndarë mendjen që të udhëtojë, atëherë lypset që ta bëjë tavāfin e lamtumirës - "tavāfu'l-veda", e pas tij të udhëtojë menjëherë. Tavāfi i lamtumirës nuk i kërkohet gruas me menstruacione ose asaj që është lehonë, nëse ajo e ka kryer tavāfin e haxhit dhe s'ajin.

Po ashtu, haxhiu ka të drejtë që therjen e hedjit ta vonojë deri në ditën e trembëdhjetë, sikurse edhe tavāfin e haxhit dhe sa'jin, deri në ditën kur të largohet nga Minã, mirëpo më me vlerë është ajo që u shpjegua më parë. Allahu është më i Dituri; Ai e lavdëroftë dhe i dhëntë paqe Profetit Muhamed dhe njerëzve të tij!

Besimi:

Përpos besimit në Zotin e Madhërishëm, në Profetin dhe në shtyllat e Islamit, Allahu Fuqiptotë i ka obliguar muslimanët që të besojnë edhe në engjëjt e Tij¹, në librat hyjnorë² që ia ka shpallur profetëve të Tij - vargu i të cilëve përfundon me Kuranin Famëlartë, i cili i ka shfuqizuar librat e mëparshëm, si dhe në mbarë profetët e dërguar nga Ai, që nga i pari e deri te i fundit - Muhamedi ﷺ, ngase mesazhi dhe thirrja e tyre qenë të njëjta, kishin një fe të përbashkët - Islamin, dhe një dërgues - Allahun, Zotin e botëve. Muslimani duhet t'i besojë të gjithë profetët e popujve të mëparshëm që janë përmendur në Kuran, si dhe ta besojë Profetin Muhamed si

¹ Engjëjt: Shpirta që Zoti i ka krijuar prej dritës. Janë të shumtë; veç Zoti e di sa janë! Disa prej tyre janë në qiell e disa, me detyra të veçanta, te njerëzit në Tokë.

² Pra, i beson për të vërteta librat e shpallur, prej të cilëve nuk ka mbetur asnjë, përveç Kuranit. Sa i përket Besëlidhjes së Re dhe të Vjetër (Teurati dhe ungjijtë), ata janë kryesisht autorësi e të krishterëve dhe e hebrenjëve, përderisa në to ka aq shumë kundërtënie dhe të pavërteta, si, fjala bie, triniteti dhe hyjnizimi i Isait, -alejhi's-selam!- (përderisa e vërteta është se vetëm Allahu meriton të adhurohet dhe se Isai është rob dhe i dërguar i Zotit). Ato fjalë hyjnore që kanë mbetur aty janë shfuqizuar me Kuranin Fisnik. Njëherë, Profeti ﷺ i pa Umerit, -radijallahu anhu!-, në dorë një fletë të Besëlidhjes së Vjetër, dhe kjo e hidhëroi fort. I tha: "A mos ke ndonjë dyshim në mua, o biri i Hatabit?! Për Zotin, po të ishte gjallë vëllai im Musai, nuk do të kishte mundësi tjetër, përpos që të më pasonte!" Umeri e hodhi letrën dhe tha: "Kërko falje për mua, o i dërguar i Allahut!"

të dërguarin e fundit dhe kumtarin e çuar te mbarë njerëzit. Pra, pas dërgimit të tij, të gjithë njerëzit e kanë për detyrë që ta besojnë e ta ndjekin atë, për çka edhe quhen që të gjithë "Umet - popull i Muhamedit", madje edhe nëse i përkasin feve të tjera.

Musai - Moisiu, Isai - Jezusi, dhe të gjithë profetët e tjerë janë larg atij që nuk e pason Muhamedin e që nuk e përqafton fenë islame. Një musliman i beson dhe i ndjek të gjithë profetët, prandaj ai që nuk e beson Muhamedin e nuk futet në Islam, konsiderohet mohues dhe përgënjeshtues i të gjithë të dërguarve të Zotit, edhe nëse pandeh se e pason ndonjë profet; e dëshmitë e kësaj të vërtete i kemi cekur më parë, saktësisht në kreun e dytë.

Profeti ﷺ thotë:

"Betohem në Atë, në Dorë të të Cilit është shpirti im; s'ka kush që dëgjon për mua nga kjo gjeneratë (tash e tutje), qoftë hebre apo i krishterë, e pastaj vdes pa besuar në atë me të cilën jam dërguar, veçse o të jetë prej banorëve të zjarrit të xhehenemit!"¹

Po ashtu duhet të besojë në ringjalljen pas vdekjes, llogarinë, shpërblimin, parajsën dhe ferrin. Gjithashtu edhe në kaderin e Zotit - parapërcaktimin hyjnor.

¹ Shënon Muslimi.

Domethënia e besimit në kader - parapërcaktimin

hyjnor:

Beson se Zoti i Gjithëdijshtëm, ende para se t'i ketë krijuar qiejt dhe Tokën, ka ditur çdo gjë dhe e ka ditur se çfarë do të bëjnë krijesat e Tij; e ato dituri Ai i ka shkruar në El-Levhu'l-mahfûdh - pllakën e ruajtur. Po ashtu beson se gjithçka ndodh vetëm me dëshirën e Allahut dhe se Zoti i ka sjellë krijesat në ekzistencë që t'i binden Atij, ndaj edhe i mësoi dhe i urdhëroi për dëgjueshmëri, sikurse edhe ua shpjegoi dhe ua ndaloi mëkatimin. Zoti u dha njerëzve aftësinë e dëshirës dhe të vullnetit, në mënyrë që t'i përgjigjen Zotit në urdhrat e Tij, e si rrjedhojë të shpërblehen, apo edhe të mëkatojnë, e për pasojë të meritojnë dënimin.

Vullneti i robit është i varur për vullnetin e Zotit të Lartë. Sa i përket atyre parapërcaktimeve hyjnore, te të cilat njeriu nuk ka ndonjë mundësi përzgjedhjeje a vullneti, siç janë gabimi, harresa, imponimi, varfëria, sëmundja e qederet e tjera, për to ai nuk ndëshkohet, përkundrazi, shpërblehet nëse tregohet durimtar dhe i pajtuar me kaderin e Allahut. E tërë kjo që u përmend është pjesë e dogmës që muslimani duhet ta besojë!

Besimtarët më të denjë e më të afërt me Zotin janë muhsinët, të cilët e adhurojnë dhe e madhërojnë Zotin, me asolloj bindjeje të fortë sikur të ishin duke e parë Atë; i shmangen mëkateve, haptazi e fshehurazi; besojnë se Ai i sheh kudo që janë, e është në dijeni të plotë për ta se çfarë

thonë, ç'bëjnë, e ç'kanë në brendësinë e tyre; i binden urdhrave të Tij, e nuk tregohen të padëgjueshëm, e nëse bien në ndonjë mëkat, kthehen me pendesë të vërtetë, i kërkojnë falje Allahut, e nuk kthehen sërish në atë mëkat!

Allahu Fuqiplotë thotë:

“Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë punëmirë.” (Kurani, 16:128)

Përsosuria e fesë islame:

Allahu i Madhërishëm në Kuranin Famëlartë thotë:

“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj.” (Kurani, 5:3)

Po ashtu, Allahu i Lartë thotë:

“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh.” (Kurani, 17:9)

Për Kuranin, Zoti Fuqiplotë thotë:

“Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për muslimanët.” (Kurani, 16:89)

E në hadithin autentik, Profeti ﷺ thotë:

"Ju kam lënë juve në udhën e qartë; nata e saj është (e qartë, po) sikur dita. Askush, përpos ndonjë farësosuri (të shkatërruari) nuk i shmanget asaj!"

Po ashtu ka thënë:

"Ju kam lënë diçka që, po u kapët për të, kurrë nuk do të devijoni: Kurani dhe tradita ime!"

Në ajetin e parë po na jepet ky sihariq i madh që, kjo fe është e përkryer, e në të s'ka kurrfarë mangësie e teprice, si dhe është e përshtatshme për çdo kohë, vend, e shoqëri. Gjithashtu, Zoti po na tregon se na ka begatuar me këtë fe të përsosur, me mesazhin e vulës së profetëve, Muhamedit ﷺ e me ngadhënjimin e kësaj feje të pazëvendësueshme, të cilën Ai e zgjodhi për njerëzimin dhe e bëri të vetmen fe të pranuar.

E në ajetin vijues, Zoti na tregon se Kurani i madhërishëm është një sistem i përkryer, që jep shpjegimet e duhura për çdo gjë që i përket jetës së kësaj bote dhe asaj të mëtejme. Aty është haberi për çdo gjë të mirë dhe vërejtja kundrejt çdo të keqeje. Për çfarëdo lloj telashesh, të vjetra a të reja, të së tashmes apo të ardhmes, aty jepet zgjidhja e drejtë, madje çdo “zgjidhje” që bie ndesh me Kuranin, në të vërtetë, s’është gjë tjetër pos injorancë e padrejtësi!

Kështututje shkenca, besimi, politika, sistemi i pushtetit, gjyqësorit, psikologjia, sociologjia, ekonomia, kodi penal, e gjëra të tjera për të cilat njerëzimi ka nevojë, që të gjitha janë të shpjeguara në Kuranin Famëlartë dhe në Sunetin profetik, ashtu siç na tregon Zoti në ajetin e lartpërmendur:

“...shpjegim për çdo çështje...” Në kreun e radhës do të flasim për përsosurinë, gjithëpërfshirjen dhe vërtetësinë e fesë islame dhe të metodologjisë së saj.

Kreu i katërt:

Metodologjia e Islamit

Së pari, sa i përket diturisë:

Obligimi i parë që Zoti i dha njeriut është nxënia e diturisë;

Allahu i Madhërishëm thotë:

“Dije se nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Allahut! Kërko falje për gjynahun tënd dhe për besimtarët e besimtare! Allahu e di se si silleni ju dhe ku qëndroni.” (Kurani, 47:19)

Po ashtu, Allahu i Lartësuar thotë:

“...se Allahu do t’i ngrejë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija.” (Kurani, 58:11)

Po ashtu, Zoti thotë:

“...dhe thuaj: “O Zoti im, shtoma dijeninë!” (Kurani, 20:114)

Gjithashtu, i Larti thotë:

“...andaj, pyetni njerëzit e dijshtëm (njerëzit e shkrimeve të mëparshme), nëse ju nuk dini!” (Kurani, 21:7)

E vula e profetëve, Muhamedi ﷺ ka thënë në një hadith të vërtetë:

"Kërkimi i diturisë është detyrë për çdo musliman!"

Po ashtu ka thënë:

“Vlera e dijetarit kundrejt vlerës së adhuruesit është sikur vlera e hënës së plotë kundrejt planetëve të tjerë!”

Në Islam, nëse e shikojmë obligueshmërinë e ditorisë, konstatojmë se ajo është disa llojesh:

Lloji i parë:

Dituri e detyrueshme dhe e pashmangshme për çdo individ, pa dallim gjinie, tek e cila kategori nuk merret në konsideratë arsyetimi me injorancë. Këtu kemi të bëjmë me njohjen e Zotit të Madhërishëm, të Profetit Muhamed صلى الله عليه وسلم dhe të çështjeve themelore të fesë islame¹.

Lloji i dytë:

Dituri e detyrueshme kolektive, nxënien dhe njohjen e së cilës duhet ta bëjë një kategori e njerëzve, e si rrjedhojë të tjerët të lirohen nga përgjegjësia dhe mëkati. Është e pëlqyeshme që mbarë kategoritë shoqërore ta mësojnë këtë dituri, mirëpo jo të gjithë e kanë detyrim. Këtu kemi të bëjmë me njohjen e hollësishme të dispozitave dhe jurisprudencës islame, nëpërmjet të cilës njohësi i kualifikuar merret me mësimdhënie, gjykim e fetva. Po ashtu, në këtë lloj bien edhe ditoritë e nevojshme për mbarëvajtjen e jetës së muslimanëve, siç janë mjeshtëritë dhe zejet, për të cilat pushtetari musliman duhet të

¹ Shpjegimi i hollësishëm veçse është paraqitur te tre krerët paraprak të librit.

angazhojë anëtarë të shoqërisë që t'i përvetësojnë ato dituri.

Së dyti, sa i përket besimit:

Allahu i Madhërishëm e ka porositur Profetin e Tij, Muhamedin صلى الله عليه وسلم që t'i mësojë njerëzit se ata janë robër të Zotit, duhet ta adhurojnë vetëm Atë, të lidhen me Të nëpërmjet adhurimit - pa ndonjë ndërmjetësues, t'i mbështeten vetëm Atij, t'i frikësohen veç Atij, e të mos i varin shpresat te askush përpos Tij, ngase vetëm Ai mund të sjell dobi a dëm, si dhe ta cilësojnë Atë me vetitë e përsosura me të cilat e ka përshkruar Ai veten e Tij ose me të cilat e ka përshkruar i Dërguari i Tij, siç edhe kemi shpjeguar më parë.

Së treti, sa i përket lidhjes ndërnjerëzore:

Zoti e ka urdhëruar muslimanin që t'i përmbahet vlerave humane, të jetë njeri i mirë dhe një pjesëtar pozitiv i shoqërisë, përherë duke u orvatur që t'i shpëtojë njerëzit nga errësira e mosbesimit e t'i shpjerë te drita e Islamit. Në përpjekje për t'iu përgjigjur kësaj urdhërese, unë e shkrova këtë libër.

Zoti ka urdhëruar që lidhja e muslimanit me të tjerët të ndërtohet në sajë të besimit te Zoti, e si rrjedhim t'i dojë besimtarët që i binden Zotit dhe Profetit të Tij, edhe nëse nuk i ka të afërm, e të mërijë gjithë ata që s'e besojnë Zotin

e s'i binden Atij ose Profetit të Tij, edhe nëse i ka fare të afërt. E pra, kjo është lidhja që vërtet mund të bashkojë njerëz të ndryshëm, ndryshe nga lidhja e gjenealogjisë, atdheut dhe e interesave materiale, e cila shumë shpejt këputet!

E Zoti i Madhërishëm tha:

“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre.” (Kurani, 58:22)

Po ashtu, Allahu i Lartësuar thotë:

“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.” (Kurani, 49:13) (Kurani, 49:13)

Në ajetin e parë, Zoti i Madhërishëm na tregon se besimtari assesi nuk i do hasmit e Zotit, edhe nëse bëhet fjalë për më të afërmit e tij. E në ajetin tjetër na dëfton se njerëzit më të fisshëm dhe më të dashur te Ai janë robërit e bindur e të nënshtruar, të çfarëdo gjinie a ngjyre qofshin.

Po ashtu, ka urdhëruar që, me mikun e armikun të jemi të drejtë dhe asnjëherë të mos bëjmë padrejtësi, madje, Ai edhe Vetes ia ndaloi zullumin. Gjithashtu, prej urdhëresave të Tij është besa, besnikëria, vërtetësia dhe shmangia nga tradhtia. Ai ka porositur që t'i trajtojmë me mirësjellje e

mirësi prindërit, të afërmit, të varfrit, madje edhe kafshët¹, kundrejt të cilave nuk guxojmë të sillemi dhunshëm, përveç kafshëve të dëmshme, si qeni që sulmon, akrepi, gjarpi, egërsira, miu, qifti (skifteri) dhe hardhuca, të cilat vriten por nuk dhunohen.

Së katërti, sa i përket shpirtërores:

Janë një sërë ajetesh në Kuranin Famëlartë, ku besimtari paralajmërohet që të jetë i kujdesshëm, ngase ai është nën mbikëqyrjen e Allahut, Ai e di përherë vendndodhjen e tij, i di qëllimet, fjalët dhe punët e tij, se të gjitha punët dhe fjalët e tij janë të regjistruara nga engjëjt dhe se një ditë do të merret në llogari nga Zoti. Po ashtu, ky Kuran ka sjellë lajmin për një dënim të dhembshëm, i cili do t'i kapë mëkatarët e pabindur ndaj Zotit. E kështu, këto të vërteta kuranore e ndalin besimtarin e druajtur prej Zotit, nga mëkati, shthurja, krimi e ndalesat.

Zoti i ka urdhëruar muslimanët që, në përpjekje për të mbrojtur e për të shpëtuar shoqërinë, të urdhërojnë për punë të mira e të ndalin të tjerët nga veprat e liga. Në një

¹ Madje, edhe në therjen e kafshëve të lejuara, nuk mungojnë porositë profetike; duhet të mprihet mirë tehu i thikës dhe të qetësohet kafsha, e cila duhet të theret në gabzherr, pra, t'i pritët gurmazi dhe dy damarët e gjakut – derisa t'i dalë gjaku në tërësi! Kurse deveja theret me një goditje me thikë në laring. Vrasja e kafshës nëpërmjet rrymës ose goditjes në kokë është e ndaluar dhe e bën mishin e saj të ndaluar për konsum.

rreth të tillë, edhe muslimani mëkatar - që s'i frikësohet denjësisht Allahut, e gjen mbarësinë, ngase aty çdo pjesëtar i shoqërisë ndihet përgjegjës për pengimin e së keqes, varësisht prej mundësive që ka, qoftë me gjuhë a me dorë.

Gjithashtu, Zoti e ka obliguar parinë muslimane që ta jetësojnë kodin penal islam - i dalë nga Kurani dhe Suneti. Aty ku praktikohet ky kod, mbretëron drejtësia, siguria, qetësia dhe rehatia.

Së pesti, sa i përket çështjeve sociale:

Zoti i ka urdhëruar muslimanët që të jenë solidarë e të ndihmojnë njëri-tjetrin, qoftë moralisht a materialisht, siç është shpjeguar më parë në kapitullin e zekatit dhe lëmoshës vullnetare. Muslimani e ka të ndaluar që t'i dëmtojë të tjerët e t'u bëjë probleme, madje e ka të ndaluar që të vërë ndonjë pengesë në rrugë, sikurse është i urdhëruar që, nëse sheh diçka të tillë, ta largojë atë, vepër kjo për të cilën do të shpërblehet; e sa i përket atij që u sjell telashe njerëzve në udhë, ai është kërcënuar me ndëshkim.

Allahu e ka obliguar besimtarin që të dojë për vëllanë e tij, atë që e dëshiron për vetveten, si dhe të mos ia dëshirojë atij atë që s'ia dëshiron vetvetes!

Allahu i Lartësuar thotë:

“Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!”
(Kurani, 5:2)

Po ashtu, i Larti thotë:

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre...” (Kurani, 49:10)

Gjithashtu, i Larti thotë:

“S’ka kurrfarë të mire në shumë prej bisedave të tyre të fshehta, përveç rastit kur ndokush kërkon që të jepet sadaka ose të kryhet një vepër e mirë apo paqësim ndërmjet njerëzve. Atij që e bën këtë për të fituar kënaqësinë e Allahut, Ne do t’i japim një shpërblim të madh.” (Kurani, 4:114)

Profeti ﷺ thotë:

"Nuk beson asnjëri prej jush derisa t'ia dojë vëllait të tij atë që ia do vetes!"¹

Në fjalimet e tij madhështore, nga fundi i jetës së tij, në haxhin e lamtumirës, i Dërguari ﷺ e tha atë që e thoshte prore gjatë misionit të tij:

"O ju njerëz! Zoti i juaj është Një; një baba e keni (Ademin alejhis-selam); nuk ka vlerë arabi kundrejt joarabit e as joarabi kundrejt arabit, as i ziu kundrejt të kuqit e as i kuqi kundrejt të ziut, përveçse në sajë të devotshmërisë! A e kumtova?!" Njerëzit thanë: I Dërguari i Allahut e kumtoi!

Gjithashtu, ka thënë:

¹ Shënon Muslimi.

"Vërtet, gjaqet, pasuritë dhe nderi juaj janë të shenjta (ndalohet cenimi i tyre), po sikurse shenjtëria e kësaj dite, në këtë muaj, në këtë vend tuajin; a jua kumtova?! Thanë: "Po!" Atëherë bëri me gisht drejt qiellit e tha: "O Allah, dëshmo!"¹

Së gjashti, sa i përket politikës së brendshme:

Zoti i Madhërishtëm i ka obliguar muslimanët që të kenë një prijes, të besëlidhjen me të, të bashkohen rreth tij, e të bëhen një tërësi e pandashme, larg përçarjeve. Po ashtu, i ka urdhëruar për bindje ndaj të parit të tyre, përpos në rast mëkatesh, për çka rregulla thotë që, nuk ka dëgjueshmëri kundrejt krijesës kur bëhet fjalë për mosbindje ndaj Krijuesit.

Gjithashtu, muslimani është i obliguar që, nëse nuk arrin dot ta jetësojë e të thërrasë në Islam në vendbanimin e tij, ai të shpërngulet në drejtim të vendeve islame - të cilat e praktikojnë shëriatin islam dhe prihen nga një udhëheqës musliman që gjykon sipas shpalljes hyjnore.

Islami nuk i merr në konsideratë kufijtë dhe ndarjet e ndërtuara mbi baza gjeografike e gjenealogjike, por identiteti i vërtetë i muslimanit është vetë Islami. Njerëzit – robërit e Zotit, për sa kohë që i përmbahen rregullave të shpallura nga Zoti janë të lirë të lëvizin në Tokën e Tij, e kur

¹ Këto janë fjalime madhështore e përmbledhëse, mirëpo janë të shpërndara nëpër libra të ndryshëm të hadithit profetik.

tregohen të padëgjueshëm, ligji i Tij mbi ta bën punë; me sheriatin e Allahut jeta e njerëzve shkon drejt e mbarë, ndërsa gjaku, nderi dhe pasuria e tyre ruhet e çmohet, kurse pa të e tërë e keqja merr dhenë.

Ligji i Zotit ofron sigurinë më të lartë për mendjen e njeriut. Gjithçka që e mpin dhe e deh mendjen e njeriut, alkool apo drogëra të ndryshme janë të ndaluara në Islam, e madje në këtë legjislacion parashihet një dënim prej 40-80 goditje kamxhikësh mbi pijanecin, në mënyrë që të pengohet e keqja e tij, qoftë ndaj vetvetes – mendjes apo ndaj shoqërisë.

Po ashtu, ky ligj i siguron gjakut të muslimanit siguri e paqe. Aty parashihet ndëshkimi me vdekje për vrasësin e padrejtë, sikurse edhe ndëshkim të duhur e të drejtë për çdo lloj plage. Gjithashtu, Islami e ka ligjësuar vetëmbrojtjen e shpirtit, nderit dhe të pasurisë.

Allahu Fuqiplotë thotë:

“Në ligjin e barazisë në ndëshkim (kisas) ka siguri për jetën tuaj, o mendarë, në mënyrë që ju të përmbaheni!”

(Kurani, 2:179)

E Profeti ﷺ thotë:

“Ai që vritet duke mbrojtur vetveten është dëshmor; ai që vritet duke mbrojtur familjen është dëshmor; ai që vritet duke mbrojtur pasurinë është dëshmor!”

Po ashtu edhe nderi i muslimanit ruhet për mrekulli në këtë fe. Përgojimi – të folurit për dikë në mungesë të tij me fjalë që ai s'i do, është i ndaluar rreptësisht në Islam. Ndërsa shpifja kundrejt nderit të muslimanit trajtohet edhe me ashpër, saktësisht nëpërmjet një kodi që parasheh një dënim të veçantë për shpifësin që nuk sjell prova.

Gjithashtu, Islami e ruan gjenealogjinë e njerëzve dhe e pengon përzierjen e tyre. E kështu, nëpërmjet ndalimit të veprave amorale, si kurvëria, duke e llogaritur prej mëkateve më të mëdha dhe e cila madje dënohet shumë rreptë në legjislacionin islam (nëse plotësohen kushtet e parapara për këtë dënim), kjo fe e ruan nderin që të mos shkelet.

Sikurse i ruan e i mbron edhe pasuritë e njerëzve, nëpërmjet ndalimit dhe ndëshkimit të vjedhjes, mashtrimit, bixhozit, mitës, e të punëve të tjera të jashtëligjshme. Hajni e cubi, nëse vërtetohet krimi i tyre, ndëshkohen me prerje të dorës, me synim që të pengohet e ndalet sherri i tyre kundrejt shoqërisë. E nëse nuk plotësohen kushtet e prerjes së dorës, edhe pse e kanë kryer krimin, ata dënohen me dënim tjetër, por që i ndalon nga përsëritja e asaj veprë.

Ai që i ka ligjësuar këto kode është Allahu – i Gjithëdijshmi, i Urti. Ai është në dijeni të plotë se çka i përshtatet më së miri krijesave të Tij, sikurse është edhe më i Mëshirshmi me ta. Këto ligje të prera, nëse aplikohen mbi një musliman, ato janë shlyerje e mëkatit të tij, ndërsa në anën tjetër, i ofrojnë shoqërisë siguri e paqe. Armiqtë e Islamit që nxjerrin fjalë kundrejt kodit islam, nuk pajtohen që të prehet një

gjymtyrë e prishur¹ që e dëmton shoqërinë, mirëpo në anën tjetër nuk u bëhet vonë që të vrasin civilë për shkak të objektivave të tyre mizore.

Së shtati, sa i përket politikës së jashtme:

Allahu i ka obliguar mbarë muslimanët - popull e pari, që t'i thërrasin të tjerët në fenë islame; që të shpëtojnë prej errësirave të mosbesimit e të dalin në dritën e besimit; të shmangen nga materializmi e nga jolumturia e të drejtohen nga jeta e vërtetë.

Pra është urdhër hyjnor që muslimani të jetë një njeri i mirë e i dobishëm për mbarë njerëzimin. Islami dallon nga të gjitha metodologjitë e tjera, të cilat e thërrasin qytetarin që të jetë vetëm një atdhetar e qytetar i mirë, ngushtësi e cila flet për kotësinë e tyre kundrejt gjerësisë së Islamit, që dëshmon për vërtetësinë e kësaj feje.

Gjithashtu, Zoti i ka urdhëruar muslimanët që, sipas mundësive, përherë të jenë të përgatitur kundër armiqve të Allahut, në mënyrë që kështu ta mbrojnë Islamin dhe muslimanët dhe t'i zmbropsin hasmit e tyre.

Zoti ua ka lejuar muslimanëve që, nëse është e nevojshme, të bëjnë marrëveshje paqeje me jomuslimanët, përherë

¹ Të prehet një gjymtyrë që e dëmton shoqërinë është më parësore sesa të prehet një e tillë kur bëhet fjalë për shëndetin e një individi të sëmurë.

duke iu përmbajtur normave islame. Muslimanët e kanë të ndaluar që t'i thyejnë besëlidhjet dhe marrëveshjet, përpos nëse armiku tradhton ose del nga marrëveshja, e atëherë muslimanët i ndërpresin marrëveshjet pasi ta kenë njoftuar paraprakisht palën tjetër.

Para se të fillojë një luftë kundrejt jomuslimanëve, fillimisht muslimanët janë të obliguar që t'i thërrasin ata në Islam, e nëse refuzojnë, atëherë u kërkohet që të japin xhizje dhe t'i binden autoritetit islam, po nëse sërish refuzojnë, atëherë fillon lufta, motoja e së cilës është ngadhënjimi i së vërtetës - që të mos adhurohet askush pos Zotit.

Muslimanët e kanë rreptësisht të ndaluar vrasjen e fëmijëve, të grave, të pleqve dhe të murgjve nëpër manastire – përpos atyre që marrin pjesë në luftë; qoftë direkt apo me ide dhe strategji. Gjithashtu janë të obliguar që të sillen mirë me robërit. Nga këtu kuptojmë mirëfilli se çlirimet-luftërat islame nuk kanë për qëllim mposhtjen dhe shfrytëzimin e popujve, por përhapjen e së vërtetës, të mëshirës dhe të udhëzimit ndër ta – t'i nxjerrin nga adhurimi i krijesave drejt adhurimit të Krijuesit.

Së teti, sa i përket lirisë:

a. Liria e besimit:

Në autoritetin islam nuk detyrohet askush që të pranojë Islamin. Jomuslimanët, pasi t'u shpjegohet Islami, janë të lirë që të zgjedhin në mes të Islamit – lumturisë e shpëtimit

dhe mbetjes në mosbesimin e tyre, aty ku është mjerimi dhe dënimi i amshueshëm. Pas kësaj oferte, ata nuk kanë më ndonjë arsyetim përpara Allahut. Që të jetojnë me fenë e tyre në truallin e pushtetit islam, ata duhet të japin xhizjen për autoritetin musliman, t'i përmbahen kodit islamik dhe të mos ekspozohen me ritet e mosbesimit përballë komunitetit besimtar.

Muslimani që e ka njohur dhe e ka pranuar të vërtetën, nuk ka të drejtë që ta braktisë atë. Dezertimi i tij ndëshkohet me vdekje, përpos nëse pendohet dhe i kthehet fesë së vërtetë – Islamit. Kthimi i heretikut i cili ka vepruar diç nga negacionet e Islamit bëhet duke e braktisur, duke e urrer dhe duke kërkuar falje te Zoti për herezinë e bërë.

Negacionet e Islamit

Negacionet e Islamit janë të shumta; më të njohurat prej tyre janë:

1. Shirku - idhujtaria, që i bie t'i përshkruash ortak Zotit e të hyjnizosh dikë bashkë me Të. Në këtë negacion hyn edhe zakoni i marrjes së krijesave për ndërmjetësues te Zoti, duke iu lutur dhe duke iu afruar sakrifica, pa marrë parasysh nëse i njeh ata si hyjni me plot kuptimin e fjalës - siç ishte rasti i idhujtarëve të periudhës së injorancës, që adhuronin idhuj që simbolizonin disa njerëz të mirë, duke shpresuar ndërmjetësimin e tyre; apo nëse nuk i njeh si hyjni duke e llogaritur adhurimin ndaj tyre si adhurim ndaj Allahut - siç është rasti me idhujtarët që i atribuohen Islamit e që nuk e

pranojnë thirrjen e teuhidit, duke pretenduar se idhujtari konsiderohet vetëm sexhdja ndaj idhullit apo të thënë për dikë përveç Allahut se ky është zoti im!

Këta i ngajnë atyre që e pinë rakinë, por e quajnë me tjetër emër, siç e kemi shpjeguar më parë!

Allahu i Lartësuar thotë:

“Andaj adhuro vetëm Allahun me përkushtim të çiltër për Të! Vetëm Allahut i takon adhurimi i vërtetë. Sa për ata që marrin mbrojtës të tjerë, përveç Tij, duke thënë: “Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu”, Allahu me siguri që do t’i gjykojë për mospajtimet që kanë pasur. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar e mohues.” (Kurani, 39:2-3)

Po ashtu, Allahu thotë:

“Ky është Allahu, Zoti juaj. Pushteti është i Tij! Kurse ata që ju i adhuron krahës Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës. Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t’ju përgjigjeshin. Në Ditën e Kiametit, ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhamed) ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm.” (Kurani, 35:13-14)

2. Gjithashtu prej gjërave që të nxjerrin prej Islamit është mosgjykimi i jobesimtarëve si jobesimtarë, si puna e idhujtarëve, hebrenjëve, të krishterëve, ateistëve, zoroastrianëve dhe mizorëve që nuk gjykojnë sipas asaj që

e ka zbritur Allahu e as që janë të kënaqur me gjykimin e Tij; kush nuk i gjykon këta si jobesimtarë, pasi të ketë kuptuar se Zoti i ka gjykuar për të tillë, del nga Islami!

3. Magjia e ndërlidhur me idhujtari; kush e vepron atë apo pajtohet me të, pasi ta ketë kuptuar gjykimin fetar, del nga Islami!

4. Besimi se ndonjë sistem i caktuar është më i mirë sesa sistemi islam, se ndonjë gjykim është më i mirë sesa ai profetik ose se të gjykosh me ligj tjetër përveç ligjit të Allahut është diçka e lejuar!

5. Urrejtja e Profetit ﷺ apo e ndonjë komponenti të fesë së tij, pasi të ketë kuptuar se bëhet fjalë për diçka të fesë së tij!

6. Tallja me diçka nga Islami, duke e ditur se i përket Islamit!

7. Mëria ndaj ngadhënjimit të Islamit ose gëzimi me disfatat e tij!

8. Miqësimi i jobesimtarëve, me dashuri e përkrahje, duke e ditur se kjo e fut atë në radhët e tyre!

9. Besimi se ka hapësirë të dilet nga sheriati i Muhamedit ﷺ edhe pse e di që askujt, në asnjë rast, s'i lejohet diçka e tillë!

10. T'i kthehet shpina fesë së Allahut - as s'e mëson e as nuk e praktikon. Nëse edhe pasi t'i kujtohet nuk ndryshon për së mbari, del nga feja.

11. Mohimi i ndonjë dispozite islame duke e ditur se ka ujdj për të. Argumentet që flasin për këto negacione janë të shumta në Kuran e Sunet.

b. Liria e mendimit:

Në Islam është e rregulluar përbrenda kornizave të përputhshmërisë me parimet islame. Muslimani është i urdhëruar që ta thotë fjalën e drejtë përpara kujtdoqoftë, të këshillojë prijësit e t'i ndalojë nga e keqja, si dhe ta demantojë e ta shmangë të kotën. Ky është sistemi më i përkryer i respektimit të lirisë së mendimit!

E sa i përket mendimit që bie ndesh me Islamin, ai nuk tolerohet që të paraqitet sheshazi, ngase kështu i hapet rrugë përplasjes me të vërtetën dhe përpjekjeve shkatërruese.

c. Privatësia dhe çështjet personale (liria personale):

Këto rregullohen përbrenda kodeksit islamik, ku individi, qoftë mashkull a femër, është i lirë të veprojë siç dëshiron, në shitblerje, në dhurata, në lënien vakëf, në falje e kështu me radhë. Ashtu si mashkulli edhe femra është e lirë që të përzgjedh se me kë dëshiron të martohet dhe asnjërit nuk mund t'i imponohet oferta e padëshiruar. Nuk tolerohet që femra të përzgjedhë një burrë që, në aspektin fetar është i papërshtatshëm për të, në mënyrë që t'i ruhet fetaria, nderi, interesi dhe familja.

Kujdestari i femrës - mashkulli më i afërt gjenealogjikisht i saj, apo i ngarkuar me këtë punë nga ana e tij është përgjegjësi që e lidh kurorën e saj martesore; ajo nuk e marton vetveten, ngase ashtu do t'i ngjasonte grave të përdala. Kujdestari i thotë burrit: "Po ta jap filanen për bashkëshorte!", e ai përgjigjet duke thënë: "E pranoj këtë martesë!". Këtë akt kurorëzimi e ndjekin dy dëshmitarë!

Muslimani nuk guxon t'i tejkalojë kufijtë e përcaktuar nga Zoti, ngase ai dhe gjithçka që posedon, i përkasin Zotit Fuqiplotë! Ai duhet të veprojë në suaza të ligjit të Allahut, i cili është një mëshirë hyjnore, të cilës kushdo që i përmbahet përudhet e lumturohet, sikurse kushdo që i kundërvihet mjerohet e shkatërrohet! Ndaj, Zoti e ka ndaluar kurvërinë, homoseksualizmin, vetëvrasjen dhe ndryshimin e krijimtarisë së Allahut në të cilën e ka krijuar atë. Te kjo e fundit nuk përfshihet shkurtimi i mustaqeve, prerja e thonjve, rruajtja e pjesëve intime, shkulja e nënsqetullave e rrethprerja (synetllëku), ngase këto janë urdhëresa fetare.

Muslimani e ka të ndaluar që t'u ngjasojë jobesimtarëve në ato çështje dhe karakteristika që janë veçori e tyre! Kjo ngase përngjasimi dhe dashuria e dukshme, shpie në përngjasim dhe dashuri të brendshme, gjegjësisht me zemër!

E Allahu dëshiron që muslimani të jetë një burim i idesë dhe mendimit të shëndoshë islam, e jo një importues i gjithfarë ideje e mendimi, sikurse dëshiron që ai të jetë një shëmbëlltëyre e mirë, e jo një ndjekës symbyllur.

E sa i përket zejeve dhe eksperiencave të reja, Islami urdhëron që ato të mësohen e të merren, edhe nëse bëhet fjalë për prurje e zbulime të jomuslimanëve, ngase shikuar thelbësisht, ai që e mëson njeriun është vetë Allahu!

Allahu i Madhërishëm thotë:

"Ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte." (Kurani, 96:5)

E kjo është pika kulmore e udhëzimit dhe e drejtimit të njeriut, që ai të përfitojë nga liria që e gëzon dhe ta ruajë dinjitetin e tij nga sherri i vetvetes dhe i të tjerëve!

ç. Liria e banimit:

Zoti e garanton këtë liri, ndaj nuk i lejohet askujt të hyjë në banesën e tjetrit pa lejen e zotit të shtëpisë, sikurse nuk guxon të hedhë shikimin nga jashtë brenda pa lejen e tij.

d. Liria e fitimit:

Muslimani është i lirë që të fitojë e të shpenzojë përbrenda normës së lejuar fetarisht, sikurse është i urdhëruar që të punojë e të fitojë për mbarëvajtjen e vetvetes e të familjes, si dhe të shpenzojë në bamirësi! Zoti i ka ndaluar disa forma të fitimit, siç janë kamata, bixhozi, ryshfeti, vjedhja, pagesat e marra nga falli, magjia, prostitucioni, homoseksualizmi, si dhe fitimet nga shitja e gjësendeve të ndaluara, si pikturat me imazhe frymore, alkooli, derri, instrumentet muzikore, këndimi e vallja. Po sikur nuk lejohet fitimi i dalë nga këto

punë, gjithashtu nuk lejohet që të shpenzohet për to! Muslimani duhet ta harxhojë pasurinë e tij vetëm në gjëra të lejuara! Me këtë sistem të përkryer, njeriu jeton i lumtur, i pasur e i sigurt me pasuri të lejuar!

Së nënti, sa i përket familjes:

Zoti i Madhërishëm i ka dhënë familjes muslimane sistemin më të përkryer familjar, në sajë të të cilit arrihet lumturia e njëmendtë. Në këtë tërësi rregullash, Ai e ligjësoi mirëbërësinë kundrejt prindërve, me fjalë të mira, vizita të rregullta nëse është larg tyre, shërbim të duhur, shpenzim pasurish nëse lypet diçka e tillë. Njëherazi, Zoti e ka kërcënuar gjithsecilin që s'i përfill prindërit dhe në anën tjetër i ka premtuar lumturi atij që sillet me ta me mirësi e respekt. Po ashtu, në këtë sistem gjejmë ligjshmërinë e martesës, urtësitë e së cilës na janë bërë të qarta në Kuran e Sunet. Prej tyre:

1. Martesa është faktori më i rëndësishëm për ndershmërinë e individit, pengimin e amoralitetit dhe kontrollimin e shikimit në haram.
2. Me martesë çifti gjejnë te njëri-tjetri prehjen dhe rehatinë; Zoti u mbjell në zemër dashuri e mëshirë për njërin-tjetrin.
3. Numri i muslimanëve shtohet nëpërmjet martesës.

4. Nëpërmjet martesës, çifti, duke e respektuar çdonjëri rolin që ia ka dhënë Zoti, e plotësojnë dhe i shërbejnë njëri-tjetrit.

Burri punon jashtë shtëpisë, që të fitojë e të shpenzojë për gruan dhe fëmijët e tij, kurse gruaja, brenda shtëpisë, merret me kujdesin ndaj fëmijëve dhe me edukimin e tyre, mbarëvajtjen e familjes dhe gatitjen e atmosferës familjare, ku të gjithë bashkërisht lumturohen dhe gazmohen!

Nuk ka ndonjë ndalesë që, me pëlqim të burrit, gruaja të punojë e të fitojë, qoftë për interesa vetjake apo bashkëshortore! Mirëpo kjo duhet të bëhet në ambiente ku nuk ka prezencë të meshkujve, përndryshe nuk lejohet.

Gruaja gëzon siguri të plotë përderisa është në shtëpinë e saj dhe përderisa nuk i ekspozohet duarve mëkatore e syve dinakë. E kur del nga shtëpia dhe u shfaqet turmave, ajo është e kanosur dhe e pakursyer nga ujqërit e pamëshirshëm!

Nëse burri nuk mjaftohet dot me një bashkëshorte, ai e ka të lejuar nga Zoti që të marrë edhe ndonjë grua tjetër - deri në katër, nëse i përmbahet kushtit të drejtësisë ndërmjet tyre - në banim, shpenzim dhe bujtje. Kjo drejtësi nuk kërkohet në atë që i përket zemrës, gjegjësisht në dashuri, ngase diçka të tillë s'e kontrollon dot njeriu, ndaj edhe nuk qortohet për të; kjo është drejtësia, realizimin e së cilës e ka mohuar Zoti me fjalën e Tij:

“Ju nuk do të mund të silleni drejt midis grave tuaja, edhe sikur të dëshironi.” (Kurani, 4:129)

Është për qëllim dashuria dhe ajo që ndërlidhet me të! Pra, kjo është një drejtësi e denjë që poligaminë nuk e ka kushtëzuar me dashurinë e barabartë, ngase diçka e tillë është e pamundur. Poligamia është një akt legjitim, si për profetët, ashtu edhe për gjithsecilin që ka mundësi dhe e realizon drejtësinë e kërkuar, ngase Zoti - Gjykuesi e Ligjvënësi i Drejtë e di më së miri se çfarë është më e mirë e më e përshtatshme për krijesat e Tij, e pa dyshim që poligamia është në interes të të dy gjinive. Një burrë i shëndoshë mund t'u mjaftojë katër grave, që secila ta përmbushë nevojën e vet dhe ta ruajë nderin!

Nëse burrat nuk marrin më shumë sesa një grua - siç është rasti i të krishterëve¹ e të tjerëve, e që në këtë po na thërrasin së fundmi, ndodhin këto dëme e probleme:

Së pari, kur burri është i devotshëm dhe i bindur ndaj Zotit, mund të ndihet i privuar përgjatë kohës kur bashkëshortja është në muajt e fundit të shtatzënisë, në lehon, menstruacione dhe sëmundje, pasi nuk mund të ketë marrëdhënie intime me të. Ai në ato periudha të gruas jeton ngjashëm me atë që s'ka fare grua! Kjo i ngjan edhe nëse kanë lidhje të shëndoshë dashurie, po nëse nuk duhen, atëherë edhe më keq!

Së dyti, nëse burri është mëkatar ndaj Zotit e tradhtar i pacipë ndodh që të bie në amoralitet dhe të shmanget nga gruaja e tij! Shumë nga ata që nuk e përkrahin poligaminë -

¹ Isai, -alejhi's-selām, - profeti i Zotit, nuk është ai që e ka ndaluar poligaminë, mirëpo janë vetë të krishterët.

që burri të ketë më shumë sesa një grua, bëjnë kurvëri me sa më shumë gra që munden. E të tillët, nëse e luftojnë poligaminë e lejuar, duke e ditur se Zoti e ka lejuar, bien në blasfemi dhe kështu dalin nga feja.

Së treti, nëse mungon poligamia, atëherë shumë gra do të privohen nga martesë dhe mëmësia, e për pasojë, femra e ndershme mbetet e vetmuar, kurse ajo e pafytyrë, sillet vërdallë nëpër maskarenj që e shkelin nderin e saj!

Dihet mirë që gratë në numër janë më shumë sesa burrat, për shkak të luftërave dhe të punëve të rrezikshme që bëjnë burrat. Sikurse dihet mirë, që femrat janë fare herët të gatshme për martesë, gjegjësisht fill pas pubertetit, ndryshe nga meshkujt, jo të gjithë kanë mundësi të martohen herët, dikush për shkak të harxhimeve të dasmës, dikush për shkak të shpenzimeve të jetës bashkëshortore e dikush për arsye të tjera. Këtu mësojmë që Islami femrën e ka trajtuar drejt dhe me mëshirë! Ata që e luftojnë poligaminë islame, ata janë armiq të femrës, të vlerave, e të profetëve! Poligamia ishte zakoni i profetëve, të cilët e realizonin atë në suaza të së lejuarës!

Kurse sa i përket xhelozisë dhe mërziisë që bien mbi gruan, kur bashkëshorti i saj merr edhe një grua tjetër, ato janë thjesht emocione që nuk mund t'u jepet përparësi kundrejt ligjit të Allahut!

Gruaja ka të drejtë, që në aktin e kurorës ta kushtëzojë burrin që të mos marrë grua tjetër. Nëse ai e pranon këtë kusht, atëherë duhet t'i përmbahet! Po nëse pastaj ndërron

mendje dhe vendos të marrë edhe një grua tjetër, atëherë gruaja e parë është e lirë, o vazhdon bashkëshortësinë me të, o kërkon zhbërjen e kurorës, pa i kthyer asgjësend prej gjërave që ka marrë prej burrit!

Në Islam shkurorëzimi është një akt legjitim, sidomos kur bëhet fjalë për martesë të dështuara, me probleme serioze e pa dashuri! Shkurorëzimi i hap udhën gjithsecilit që të gjejë partnerin e duhur me të cilin mëton të lumturohet, qoftë në këtë botë, po edhe në botën tjetër¹, nëse vdesin si muslimanë.

Së dhjeti, sa i përket shëndetit:

Themelet e mjekësisë nuk mungojnë në fenë islame; Në Kuran, e Sunet jepen shumë shpjegime rreth një sërë sëmundjesh psikike e fizike, si dhe udhëzime të ndryshme se çfarë kura shpirtërore dhe materiale mund të ndiqen për t'i tejkaluar ato!

Allahu i Lartësuar thotë:

“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët...” (Kurani, 17:82)

¹ Në parajsë, femrave u jepet mundësia që të përzgjedhin bashkëshortin parajsor, përveç nëse bëhet bashkë me burrin e kësaj jete! Nëse në këtë botë është martuar më shumë se një herë, atëherë e përzgjedh më të dashurin e saj.

Profeti ﷺ ka thënë:

“Nuk e ka lëshuar Zoti ndonjë sëmundje, veçse ka zbritur për të një ilaç; e diti kush e diti, s’e diti kush s’e diti!”

Po ashtu ka thënë:

“O robër të Allahut, kurohuni, por mos e bëni atë me diçka të ndaluar!”

Në librin "Zadu'l-me'ād fī hedji hajri'l-'ibād", të autorit kolosal, Ibnu'l-Kajimit, gjejmë shpjegime më të gjera në këtë drejtim. Ky libër llogaritet ndër veprat më të sakta, e më gjithëpërfshirëse në shpjegimin e Islamit dhe në jetëpërshekrimin e Profetit ﷺ ndaj ia vlen të lexohet!

Së njëmbëdhjeti, sa i përket ekonomisë, tregtisë, prodhimtarisë, bujqësisë dhe nevojave të tjera të njerëzve, si uji, ushqimi, mbarëvajtja e vendbanimeve - qytete, e fshatra, luftimi i korrupsionit, mashtrimit, gënjeshtres etj.;

Të gjitha këto janë të shpjeguara në Islam, me një shpjegim të gjerë e të plotë!

Së dymbëdhjeti, sa i përket shpalosjes së armiqve të fshehtë dhe udhëzimit për mënjanimin e tyre:

Në Kuran na dëftohet që njeriu është i kanosur nga shumë armiq, nga të cilët, -po i dëgjoi-, i vjen shkatërrimi i vërtetë,

në dunja e në ahiret! Aty nuk mungojnë paralajmërimet dhe udhëzimet se si të hiqen qafesh këta armiq; e ata janë:

I pari i tyre, djalli i mallkuar - nxitësi dhe mësuesi i mbarë armiqve të tjerë të njeriut. Ai është armiku i babait tonë, Ademit dhe i nënës sonë, Havasë; dalja e tyre prej parajsës ngjau për shkak të intrigave të tij! E për sa të jetë kjo jetë, ai është armiku i përhershëm i pasardhësve të Ademit! Ai këmbëngul që t'i largojë njerëzit nga besimi në Zotin e Madhërishëm e t'i marr me vete në dënimin e përhershëm - në zjarr! E nëse nuk arrin dot t'i shpjerë në mosbesim, atëherë i nxit për mëkate e mosbindje ndaj Zotit, që kështu t'i kapë hidhërimi dhe dënimi i Tij!

Djalli e përshkon brendësinë e njeriut po sikur gjaku: i bën cytje shpirtit dhe ia josh vazhdimisht të keqen! E udhëzimi hyjnor na thotë që, kur të na kaplojë hidhërimi ose dëshira për mëkate, të themi: "E'udhu bil-lahi mine'sh-shejtāni'r-raxhīm!" (Kërkoj mbrojtje e strehë tek Allahu, që të më ruajë nga djalli i mallkuar!), dhe të flakim tutje hidhërimin, të shmangim mëkatet e të kemi parasysh që shkëndijat e së keqes ndizen nga djalli, synimi i të cilit është shkatërrimi i njeriut e pastaj shfajësimi i vetvetes dhe distancimi i tij nga njeriu!

Allahu i Lartë thotë:

“Me të vërtetë, djalli është armik për ju, andaj vështrojeni si armik! Ai vetëm i josh ithtarët e vet, që të bëhen banues të zjarrit të përflakur.” (Kurani, 35:6)

Armiku i dytë: Epshi - teket, të cilat manifestohen me refuzim të së vërtetës - veç pse ajo vjen nga dikush tjetër, refuzim të ligjit të Allahut - veç pse nuk përputhet me dëshirat e tij dhe favorizim të emocioneve kundrejt së vërtetës dhe drejtësisë.

Që njeriu të shpëtojë nga ky dushman, duhet t'i kërkojë Allahut ndihmë - që të mos shndërrohet në ndjekës epshi, si dhe duhet ta përmbajë vetveten që të mos i përgjigjet tekave të tij, por përherë ta thotë, e ta pranojë të vërtetën edhe nëse është e hidhur, e të kërkojë strehë, e mbrojtje te Allahu, që ta ruajë nga djalli i mallkuar!

Armiku i tretë: Nefsi dhe egoja e prirë për ligësi! Nga aty burojnë dëshirat e liga për amoralitet, alkool, prishje të paarsyeshme të agjërimit e haramë të tjera!

Që njeriu të shpëtojë nga ky hasëm, duhet t'i kërkojë strehim Allahut, që ta ruajë nga e keqja e unit dhe e djallit të mallkuar, si dhe të durojë kundrejt epsheve të ndaluara duke synuar kënaqësinë e Zotit. Nëse njeriu duron kundrejt një ushqimi të dëmshëm - edhe pse i pëlqen, ai ashtu duhet të durojë edhe kundrejt epsheve të ndaluara, të cilat janë të përkohshme dhe fundi i të cilave është dhimbje, keqardhje e mjerim.

Armiku i katërt: Njerëzit e djallëzuar! Bëhet fjalë për njerëz të shthurur, mëkatarë e lodra të djallit: e bëjnë të keqen dhe e propagandojnë atë. Për të shpëtuar prej sherrit të tyre, duhet të mos mbahen afër e t'u shmangemi skajshmërisht!

Së trembëdhjeti, sa i përket synimit të lartë dhe jetës së lumtur:

Te muslimanët, kjo jetë e përkohshme nuk vlerësohet si një synim i lartë, por thjesht si një mundësi për t'u përgatitur për jetën e vërtetë e të amshueshme: jetën e fundit - jetën tjetër!

Ndaj, muslimani i vërtetë punon e investon për jetën e mëtejme dhe nuk e bën këtë jetë qëllim të tij.

E mendon fjalën e Allahut të Lartë:

“Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” (Kurani, 51:56)

Po ashtu fjalën e Tij:

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju! Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut). Nuk janë të barabartë banorët e Xhehenemit dhe banorët e Xhenetit; banorët e Xhenetit do të jenë të fituarit.” (Kurani, 59:18-20)

Gjithashtu fjalën e Tij:

“...kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.” (Kurani, 99:7-8)

Po ashtu i kujton këto fjalë të Zotit, e të tjera si këto, ku dëftohet arsyja e krijimit të njeriut dhe e ardhmja e pashmangshme e tij, e si rrjedhim përgatitet me adhurim e bindje ndaj Zotit, përherë me shpresë që të fitojë shpërblimin hyjnor në të dy botët!

Sa i përket kësaj jete, ky shpërblim manifestohet me jetesë të këndshme, afërsi me Zotin, mbrojtje hyjnore, vizion të ndriçuar me dritën e Zotit dhe kënaqësi e qetësi kur kryen obligimet, kur e kujton Zotin me zemër e mendje, kur i flet Zotit dhe kur e përmend Atë!

Po ashtu, ai shndërrohet në një personalitet përplot vlera; me punë e me fjalë u bën njerëzve mirë, pa marrë parasysht nëse ata janë mirënjohës, e që kjo gjë e lumturon, apo bukëpërbuzës kundrejt të mirave të tij, e kjo gjë nuk e ndalon nga punët e tij, ngase qëllimi i mirësisë së tij është vetëm shpërblimi i Allahut të Lartësuar.

Është stoik në rrugën e Allahut; edhe nëse ngacmohet e përqeshet nga armiq të fesë, kjo aspak s'e kthen mbrapa, përkundrazi vetëm çka ia shton dashurinë dhe qëndrueshmërinë në fe, ngase në këso raste i kujtohen sprovat e profetëve dhe shëmbëllet me ta! Është punëtor shembullor, ashtu siç do vetë Zoti; kudo që punon, në zyrë, në fushë, në treg a në fabrikë, ai punon me zell, me nder e me besnikëri, që të jetë i dobishëm për Islamin, për muslimanët, për vetveten, për familjen dhe për nevojtarët, e kështu të fitojë shpërblimin e Allahut Fuqiplotë e të jetojë i pasur në zemër, i nderuar e i kënaqur! Është i matur, shtëpiak, e dinjitoz: ha e pi me masë e pa shpërdorim, e

kështu mëkëmbet për t'i kryer obligimet ndaj Zotit; kryen marrëdhënie intime me bashkëshorten e tij, e kështu e ruan nderin e vet dhe të gruas, si dhe trashëgohet me pasardhës, të cilët e adhurojnë Allahun, luten për prindërit dhe e shtojnë komunitetin musliman! Është mirënjohës i denjë; për çdo mirësi e begati e falënderon Zotin e Lartë, duke besuar bindshëm se të mirat vijnë vetëm nga Ai!

Është durimtar i vërtetë: nëse sprovohet me uri, frikë, sëmundje e qedere të tjera, e di që kështu e ka caktuar Zoti, që nëpërmjet këtyre provave ta shohë - edhe pse e di më së miri¹, durimin dhe pajtimin e tij kundrejt parapërcaktimit hyjnor të Allahut të Madhërishëm, ndaj dhe duron, pajtohet dhe falënderon, duke lakmuar shpërblimin e Tij për durimtarët! Kështu besimtarit i lehtësohet sprova dhe e përballon atë më lehtë, sikur i sëmuri që mëton të shërohet e që e pranon të hidhurën e ilaçit pa ngurrim!

Kur muslimani jeton sipas urdhrave hyjnore dhe synon jetën e vërtetë të amshimit e fiton paqen e pasosur dhe lumturinë e përhershme: fatlum në këtë botë dhe fatmirë në amshim!

¹ Paraprakisht, Zoti i Gjithëdijshtëm e ka dijeninë e Tij se si do të sillen njerëzit kundrejt urdhëresave e ndalesave të Tij, mirëpo i nxjerr ato sheshazi, që në Ditën e Gjykimit të mos thotë robi mëkatar se Zoti po më dënon pa bërë gjë; Zoti i Lartë thotë: "E, Zoti yt, nuk u bën zullum robërve (të Vet)." (Kurani, 41:46)

Allahu i Madhërishëm thotë:

“Sa për shtëpinë e botës tjetër, Ne do ta caktojmë atë për ata që nuk kërkojnë as madhështi e as ngatërresa në Tokë. Përfundimi (i mirë) është për ata që ruhen nga të këqijat.”
(Kurani, 28:83)

E të vërtetën e ka thënë Zoti Fuqiplotë:

“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.” (Kurani, 16:97)

Në këtë ajet, e gjetiu, Zoti na tregon se vepërmirët dhe vepërmirët, që synojnë kënaqësinë e Zotit, gëzohen me shpërblimet e Tij në të dy botët: jetë të mirë dhe të lumtur këtu e parajsë të përhershme atje!

Në këtë drejtim, Profeti ﷺ thotë:

“Është për t’u çuditur me çështjen e besimtarit sepse tërë puna dhe gjendja e tij është mirësi. Kjo vlen vetëm për besimtarin. Kështu, nëse i ndodh ndonjë gëzim, falënderon, gjë që është mirë për të. Ndërkaq, nëse e godet ndonjë gjë e keqe, duron, gjë që është mirë për të.”

Pra, sistemi i plotë e i drejtë, mendimi i shëndoshë dhe kriteri i saktë që e ndan të keqen nga e mira gjenden në Islam. Ndaj te kjo fe duhet të kthehen e të riparohen të gjitha teoritë dhe idetë e psikologjisë, sociologjisë, pedagogjisë, politologjisë, ekonomisë dhe të sistemeve njerëzore, ngase çdo gjë që bie ndesh me këtë të vërtetë

hyjnore sjell qeder e jo sukses, si dhe sjell palumturi në të
dy botët!

Kreu i pestë:

Largimi i disa dyshimeve

Së pari: Ata që e dëmtojnë Islamin dhe imazhin e tij:

Ata kryesisht janë dy lloj njerëzish:

Lloji i parë:

Njerëz që i përshkruhen Islamit dhe komunitetit musliman, por që veprojnë e flasin në kundërshtim me mësimet islame! Islami është larg tyre dhe nuk pranon të përfaqësohet nga të tillët, siç janë:

a. Të lajthiturit me dogma e besime prapanike, si puna e atyre që sillen rreth varreve, i luten të vdekurve dhe besojnë se dëmi e dobia mund të vijnë prej tyre e kështu me radhë!

b. Të shthururit, që kanë lënë pas dore fenë dhe moralin, që nuk kryejnë obligimet fetare e bëjnë mëkate pareshtur - siç janë amoraliteti dhe pirja e rakisë, si dhe miqësohen e i duan jobesimtarët dhe u ngjasojnë atyre!

c. Muslimanët e dobët në besimin dhe fetarinë e tyre, që nuk e jetësojnë denjësisht Islamin dhe që bëjnë disa mëkate e ligësi - që nuk arrijnë deri te mëkati i idhujtarisë, si gënjeshtria, mashtrimi, mospërmbyshja e premtimit, smira etj. Të këtillët i bëjnë dëm Islamit, ngase jomuslimanët kur i shohin këta muslimanë të ligë, me vepra e zakone të këtilla, mund të mendojnë se Islami i toleron të veprojnë

kështu, edhe pse Islami i ndalon këto gjëra dhe i konsideron prej mëkateve të mëdha.

Kurse lloji i dytë:

Gjithashtu, Islamin e dëmtojnë edhe një palë tjetër hasmish: orientalistët, misionarët e krishterë e hebrenj dhe të ngjashmit me ta, që u pengon përsosuria dhe shtrirja e Islamit - fesë së natyrës fillestare¹. Po kjo fe përherë është pranuar lehtësisht nga njerëzit me natyrë të shëndoshë. Ndërkaq, feve të tjera u mungon përputhshmëria me natyrën e paprekur njerëzore, ndaj ithtarët e tyre jetojnë në depresion e dilema, ndryshe nga ithtarët e Islamit, që jetojnë të lumtur e te kënaqur, ngase feja e tyre hyjnore përputhet për mrekulli me natyrën e pastër njerëzore!

Ndaj, u themi ithtarëve të feve të kota se Islami është pjesë e brendësisë së dëlirë të fëmijëve tuaj - kur ata vijnë në këtë jetë, mirëpo janë përpjekjet tuaja të dëmshme ato që i shmangin ata nga e vërteta e i vënë në humnerë dhe humbje!

Këta smirakë - orientalistët dhe misionarët, nuk kanë ngurruar që të shpifin kundrejt Islamit dhe profetit: herë

¹ Profeti ﷺ ka thënë: "Çdo foshnje lind në natyrën e paprekur fillestare; mirëpo janë prindërit ata që pastaj e bëjnë atë hebre, të krishterë ose zoroastrian!" Ky hadith autentik na dëfton se Islami është i gdhendur fort në natyrën fillestare të njeriut, ndaj nëse njeriu lihet i lirë, doemos do ta përqafojë Islamin. E, përqaqimi i feve dhe i doktrinave të kota nuk vjen ndryshe pos si rrjedhojë e përpjekjes prindërore.

duke e përgënjeshtuar mesazhin e tij e herë duke e akuzuar me ndonjë të metë - ndonëse ai qe pa kurrfarë të mete, e herë duke ia prishur imazhin disa dispozitave islame, me synim që t'i ftohin njerëzit prej Islamit!

Mirëpo Zoti i asgjëson komplotet e tyre, ngase ata i janë kundërvënë të vërtetës, kurse ajo përherë është ngadhënjimtare!

Allahu i Lartë thotë:

“Ata dëshirojnë të fikin dritën e Allahut me gojën e tyre, por Allahu e përsos dritën e Vet, edhe nëse (këtë gjë) e urrejnë jobesimtarët. Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e vërtetë, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët.” (Kurani, 61:8-9)

Së dyti: Burimet e Islamit

Nëse dëshiron ta mësosh Islamin ashtu siç është, atëherë lexoje Kuranin Famëlartë, Sunetin autentik, gjegjësisht koleksionet e hadithit, si "Sahīh"-u i Buhariut, "Sahīh"-u i Muslimit, "El-Muvata" e Imam Malikut, "Musned el Imam Ahmed ibn Hanbel", "Sunen"-i i Ebu Davudit, "Sunen"-i i Nesaiut, "Sunen"-i i Tirmidhiut, "Sunen"-i i Ibn Maxhes, "Sunen"-i i Darimiut; gjithashtu "Es-Sīratu'n-nebevijje" e Ibn Hishamit, "Tefsīru'l Kur'āni'l-'adhīm" e kolosit Ismail ibn Kethir, "Zādu'l-me'ād fī hedji hajri'l-'ibād", e eruditit Muhamed ibnu'l-Kajjim, e autorë të tjerë prej ithtarëve të

teuhidit dhe davetit të mirëfilltë islam, si Shejhu'l-Islam Ahmed ibn Tejmije, e imami ripërtërirës Muhamed ibn Abdi'l-vehāb, e që me këtë të fundit dhe imamin e muvahidëve - Muhamed ibn Suud, Zoti i Madhërishëm, në shekullin e dymbëdhjetë hënor, në Gadishullin arabik, e rimëkëmbi fenë e Tij të shenjtë!

Ndërsa sa i përket literaturës së shkruar nga orientalistët dhe ithtarët e së kotës - si puna e atyre që i shajnë ose shpifin kundrejt sahabëve dhe dijetarëve që thërrisin në teuhid, si Ibn Tejmije, Ibnu'l-Kajjim e Muhamed ibn Abdi'l-vehab, ajo është literaturë devijuese, ndaj kujdes, mos u mashtro nga to e as mos i lexo!

Së treti: Shkollat islame (medh'hebet):

Të gjithë muslimanët i përkasin një shkolle - Islamit, kurse për referencë e kanë Kuranin dhe traditën e Profetit ﷺ. E sa i përket asaj që quhet "medhhebe islame" - shkolla islame, siç është shkolla hanbelite, malikite, shafiite e hanefite, në të vërtetë, ato janë shkolla të jurisprudencës islame. Me këto shkolla dijetarët kanë përhapur meditimet dhe përqasjet e tyre rreth ajeteve kuranore dhe haditheve profetike, ndaj ato u atribuohen atyre, e më vonë u konsideruan si shkolla të mëvetësishme. Këto shkolla janë në pajtueshmëri të plotë me bazat e Islamit; ato në tërësi e kanë Kuranin dhe traditën profetike si referencë të tyre. Nëse ekziston ndonjë mospajtim në mes tyre, atëherë doemos bëhet fjalë për raste të rralla që nuk kanë të bëjnë

me themelet e fesë. Secili dijetar prej tyre i ka urdhëruar nxënësit e vet që të marrin vetëm fjalët e mbështetura nga Kurani dhe hadithi, kushdo qoftë thënësi i asaj fjale.

Parimisht, muslimani nuk e ka për obligim fetar që t'i përmbahet ndonjëres nga këto shkolla, ngase në të vërtetë, ai është i obliguar që t'i kthehet Kuranit dhe hadithit. E ajo që sot shumë prej ithtarëve të këtyre shkollave, ndjekin devijime e besëtytni me praktika prapanike nëpër varre e tyrbe, duke kërkuar ndihmë nga të vdekurit; ose duke keqinterpretuar cilësitë e Allahut, duke mos e marrë në konsideratë kuptimin e dukshëm të tyre; vërtet, këta me këto lajthitje kanë kundërshtuar besimin e vetë imamëve të shkollave të tyre, ngase ata e kishin besimin e pastër të të parëve tanë të mirë, për të cilët kemi folur më parë te pala e shpëtuar.

Së katërti: Sekte të dala nga korniza e Islamit:

Në botën islame ekzistojnë disa sekte heretike, të cilat, megjithëse i atribuohen Islamit dhe komunitetit musliman, nuk kanë kurrfarë lidhjeje me Islamin, pasi besojnë në dogma krejtësisht të kota. Prej tyre:

Sikti batini: Besojnë në panteizëm, rimishërim dhe ndarje të teksteve të shenjta në tekste me domethënie të jashtme (eksoterike) dhe tekste me domethënie të brendshme (esoterike), të cilat domethënie janë të kundërta me atë që e ka shpjeguar Profeti dhe rreth të cilave ka unanimitet te

muslimanët, e këtë të fundit (domethënien e brendshme) e manipulojnë si duan vetë.¹

Me ngadhënjimin e Islamit në trojet perse, disa grupacione hebreje, zoroastriane dhe ateisto-filozofike të atij vendi, ishin marrë vesh që të krijojnë një sekt përçarës, që të përhapnin devijime, e dilema ndër muslimanë. Ata pandehnin se ishin pasardhës të familjes profetike, maskë kjo e përdorur për të mashtruar sa më shumë njerëz. Këtu ishin fillet e sektit batini.

Në këto sekte bën pjesë edhe kadijanizmi, që i përshkruhet Gulam Ahmed El-Kadijanit - një injorant që pretendonte profetësinë, e që, në Indi, e atypari, i thërriste njerëzit që ta besonin atë. Kolonia angleze në Indi, dinte shumë mirë ta shfrytëzonte atë për interesat e veta, ndaj nuk ngurronte që t'i ofronte atij çdo lloj përkrahje, derisa shumë njerëz të padijshëm u mashtruan prej tij. Kadijanizmi dinte të paraqitej si një formacion islam, kurse në të vërtetë, nuk ishte gjë tjetër pos një përpjekje për nxjerrjen e njerëzve nga Islami! Gulam El-Kadijani u shqua me librin "Teşdiq berāhīn ahmedijje", ku pandehte se është profet dhe i

¹ Ky sekt ka emra të ndryshëm dhe degëzohet në disa grupe, në Indi, Levant, Iran, Irak, e gjetkë. Më gjerësisht rreth tyre, prej dijetarëve të hershëm ka shkruar Esh-Shihristani – në librat rreth feve dhe sekteve, e prej të mëvonshmëve, Muhamed Seid Kejlani – në "Dhej'lu'l-mileli ve'n-niheli" e Abdu'l-kadir Shejbetu El-Hamed – profesor në Universitetin Islamik të Medinës, në "El-Edjanu ve'l-fireku ve'l-medhahibu'l-muasira"; Ata kanë treguar se prej sekteve të reja në këtë domethënie është edhe kadijanizmi dhe bahaizmi.

shtrembëroi tekstet islame, siç bëri me konceptin e xhihadit, të cilin e paraqiti si të abroguar dhe se çdo musliman duhet të bëjë paqe me koloninë angleze. Përgjatë kësaj periudhe e shkroi librin: "Tirjāku'l-ḵulūb".

Pasi mashtroi shumë njerëz, në vitin 1908 ai ndërroi jetë, dhe la pas vete një mashtrues tjetër që t'i prijë sektit, i quajtur El-Hakim Nuru'd-din.

Gjithashtu, në sektet batinije heretike bën pjesë edhe bahaizmi, i themeluar në Iran, në vigjilje të shekullit të nëntëmbëdhjetë, nga 'Ali Muhamed - ose Muhamed 'Ali Esh-Shirāzi, një shiit i sektit "Esh-shi'atu'l-ithnej 'asherijje". Çudirat dhe devijimet e tij nuk ndaleshin, në fillim pretendonte se ai ishte Mehdiu i pritur, pastaj pandehte se Zoti i Lartë është mishëruar në të dhe se ai është hyjnia e njerëzve, e mohonte ringjalljen, llogarinë, paraajsën e ferrin, ndiqte jobesimtarët hindusë e budistë, ftonte në unifikimin e feve, Hebraizmit, Krishterimit dhe Islamit duke pandehur se s'ka dallim në mes tyre. Pastaj e mohoi profetësinë e Muhamedit ﷺ dhe një tërësi të madhe të dispozitave islame. Pas vdekjes së tij, rolin e tij e mori Bahaiu, i cili pastaj e përhapi këtë dogmë dhe ajo u quajt me emrin e tij.

Po ashtu në sektet heretike - që nuk konsiderohen muslimanë, edhe nëse falen, agjërojnë e bëjnë haxh, bën pjesë edhe sekti që pretendon se Xhibrili, -'alejhi's-selām!-, ka bërë një tradhti, teksa mesazhin që i qe dedikuar Aliut, ai kishte dorëzuar Muhamedit ﷺ. Disa nga ky komunitet besojnë se Aliu është vetë Allahu dhe e madhërojnë

skajshmërisht atë, si dhe pasardhësit dhe gratë e tij, sidomos Fatimenë - dhe nënën e saj, Hadixhenë. Madje i hyjnizojnë ata paralelisht me Allahun, besojnë se janë të pagabueshëm dhe se pozita e tyre tek Allahu është më e lartë se ajo e profetëve!

Ata thonë se Kurani të cilin e kanë sot muslimanët në duart e tyre është i ndryshuar - me shtim, e pakësim, ndaj edhe kanë sajuar mus'hafe të veçanta për komunitetin e tyre, ku kanë hequr e shtuar ajete e kaptina si kanë dashur vetë. Ata i shajnë Ebu Bekrin dhe 'Umerin, -radijallahu anhuma!-, dy burrat më të fisshëm pas Profetit ﷺ dhe Aishen - radijallahu anha!-!. Manifestojnë doke idhujtarie kundrejt Aliut dhe bijve të tij - duke iu lutur në halle e rehati dhe duke i hyjnizuar. Aliu dhe bijtë e tij janë larg tyre, ngase këta janë idhujtarë, gënjeshtarë e shtrembërues!

Këto sekte heretike që i përmendëm janë disa nga ato grupacione të mosbesimit që i atribuohen Islamit, por të cilat në të vërtetë, synojnë shkatërrimin e tij! Ndaj, o njeri i arsyeshëm, o musliman, ji i vëmendshëm, Islami nuk është thjesht pretendim, por njohje dhe jetësim i Kuranit dhe Sunetit autentik, te të cilat, po i meditove thellë, do të gjesh udhëzimin, dritën dhe udhën e drejtë, e cila shpie përshkuesin e saj në lumturinë e parajsës, te Zoti i botëve!

Thirrja për shpëtim

O njeri i arsyeshëm, qofsh mashkull a femër, që ende nuk ke hyrë në Islam - ty po ta drejtoj këtë thirrje për shpëtim dhe lumturi:

Shpëtoje vetveten nga dënimi i Zotit - dënimi në varr dhe në ferr!

Shpëtoje veten duke e besuar Allahun për Zot, Muhamedin për Profet e Islamit për fe. Thuaj me gjithë zemër e vërtetësi: "Lā ilāhe il-lall-llāh, Muḥammedu'rr-rresulu'll-llāh" (Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut; Muhamedi është i Dërguari i Allahut), fali pesë kohët e namazit, jepe lëmoshën e detyrueshme, agjëroje muajin ramazan dhe, nëse i ke mundësitë, bëje haxhin në Shtëpinë e Shenjtë të Zotit.

Shpalle dorëzimin tënd ndaj Zotit dhe pranimin e Islamit! Nuk ka mundësi tjetër për të arritur lumturinë përpos kësaj.

Unë po betohem në Zotin e Madhërishëm, përveç të Cilit nuk ka hyjni që meriton të adhurohet, se vetëm Islami është feja e vërtetë dhe se përveç saj Zoti nuk pranon asnjë fe tjetër. Po ashtu, për dëshmitar kam Zotin, engjëjt dhe mbarë krijesat se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, dhe se pikërisht Islami është e vërteta, e unë jam prej muslimanëve.

I lutem Zotit dhe i përgjërohem, që me mirësinë dhe bujarinë e Tij, të na e mundësojë të gjithë neve - mua, pasardhësve dhe vëllezërve të mi muslimanë, që të dalim nga kjo botë duke qenë muslimanë të denjë. Na bëftë bashkë në parajsat e begative me Profetin besnik, me familjen dhe shokët e tij, po edhe me mbarë profetët e Zotit. Lus Zotin që ta bëjë këtë libër të dobishëm për gjithsecilin që e lexon a e dëgjon. A e kumtova?! O Zot, dëshmo!

Allahu është më i Dituri! Zoti e bekoftë dhe e lavdëroftë Profetin tonë Muhamedin, familjen dhe të gjithë shokët e tij. Allahut, Zotit të botëve, i takon falënderimi i përkryer.

Përmbajtja

Hyrje dhe kushtim.....	3
Kreu i parë.....	5
Njohja e Allahut – Krijuesit madhështor	5
Qëllimi për të cilin Allahu i solli njerëzit dhe xhinët në ekzistencë.....	14
Ringjallja pas vdekjes, llogaria dhe shpërblimet për veprat e bëra, paraqja dhe skëterra (Xheneti dhe Xhehenemi) ...	16
Mbarështimi i punëve dhe fjalëve të njeriut:	20
Shehadeti - deklarata islame.....	21
Kreu i dytë:.....	22
Njohja e Profetit.....	22
Mrekullitë e Profetit Muhamed	25
Argumenti logjik dhe kuranor që tregon se Kurani është fjalë e Allahut, kurse Muhamedi Profet i Allahut.....	27
Një thirrje për ta besuar Allahun dhe Profetin e Tij.....	30
Kreu i tretë:	31
Njohja e fesë së vërtetë – Islamit.....	31
Përkufizimi dhe paraqitja e Islamit	31
Shtyllat e Islamit.....	35
Shtylla e parë: Dëshmia se s'ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij....	36
Shtylla e dytë e Islamit: namazi	52

Shtylla e tretë e Islamit: zekati - lëmosha e detyrueshme	62
Shtylla e katërt e Islamit: agjërimi	64
Shtylla e pestë e Islamit: haxhi – pelegrinazhi	67
El-mevākīt - pikënisjet gjeografike të pelegrinazhit:.....	70
Si hyhet në ihrām?	71
Ndalesat e pelegrinit:	72
Besimi:.....	78
Domethënia e besimit në kader - parapërcaktimin hyjnor:	80
Përsosuria e fesë islame:.....	81
Kreu i katërt:	84
Metodologjia e Islamit	84
Negacionet e Islamit	96
Kreu i pestë:	115
Largimi i disa dyshimeve	115
Thirrja për shpëtim	123



موسوعة المصطلحات الإسلامية
TerminologyEnc.com



موسوعة تضم ترجمات المصطلحات الإسلامية وشرحها بعدة لغات



موسوعة الأحاديث النبوية
HadeethEnc.com



موسوعة تضم ترجمات للأحاديث النبوية وشرحها بعدة لغات



موسوعة القرآن الكريم
QuranEnc.com



موسوعة تضم تفاسير وترجمات موثوقة لمعاني القرآن الكريم

IslamHouse.com



مرجعية مجانية إلكترونية
موثوقة للتعريف بالإسلام



منتقى
المحتوى الإسلامي



موسوعة تضم المنتقى من
المحتوى الإسلامي باللغات

الإسلام بأكثر من 100 لغة

جمعية خدمة المحتوى
الإسلامي باللغات



جمعية الدعوة
وتوعية الجاليات بالربوة

